 - ✓ While the effects of globalization can be observed, analyzing the net impact is more complex. Proponents often see specific results as positive and critics of globalization view the same results as negative. A relationship that benefits one entity may damage another, and whether globalization benefits the world at large remains a point of contention.
- Globalization enables countries to access less expensive natural resources and lower cost labor. As a result, they can produce lower cost goods that can be sold globally. Proponents

of globalization argue that it improves the state of the world in many ways, such as the following:

- ✓ Solves economic problems. Globalization moves jobs and capital to places that need these resources. It gives rich countries access to lower cost resources and labor and poorer countries access to jobs and the investment funds they need for development.
- ✓ Promotes free trade. Globalization puts pressure on nations to reduce tariffs, subsidies and other barriers to free trade. This consequently promotes economic growth, creates jobs, makes companies more competitive and lowers prices for consumers.
- ✓ Spurs economic development. Theoretically, globalization gives poorer countries access to foreign capital and technology they would not otherwise have. Foreign investment can result in an improved standard of living for the citizens of those nations.
- ✓ Encourages positive trends in human rights and the environment. Advocates of globalization point to improved attention to human rights on a global scale and a shared understanding of the impact of people and production on the environment.
- ✓ Promotes shared cultural understanding. Advocates view the increased ability to travel and experience new cultures as a positive part of globalization that can contribute to international cooperation and peace.

Conclusions

This article presents a wide range of views on a broad range of topics related to globalization, development, and the law. There is a general consensus that legal institutions and good governance are important for both managing globalization and achieving development, and that these institutions go beyond "law" or "policy" to encompass the basic structures of society itself. In an interconnected world, developing countries can sometimes benefit from institutional links that were formed by developed countries.

As globalization has progressed, living conditions (particularly when measured by broader indicators of wellbeing) have improved significantly in virtually all countries. However, the strongest gains have been made by the advanced countries and only some of the developing countries.

No country, least of all the poorest, can afford to remain isolated from the world economy. Every country should seek to reduce poverty. The international community should endeavor—by strengthening the international financial system, through trade, and through aid—to help the poorest countries integrate into the world economy, grow more rapidly, and reduce poverty. That is the way to ensure all people in all countries have access to the benefits of globalization.

Growth in living standards springs from the accumulation of physical capital (investment) and human capital (labor), and through advances in technology (what economists call total factor

productivity). Many factors can help or hinder these processes. The experience of the countries that have increased output most rapidly shows the importance of creating conditions that are conducive to long-run per capita income growth. Economic stability, institution building, and structural reform are at least as important for long-term development as financial transfers, important as they are. What matters is the whole package of policies, financial and technical assistance, and debt relief if necessary.

Markets promote efficiency through competition and the division of labor—the specialization that allows people and economies to focus on what they do best. Global markets offer greater opportunity for people to tap into more and larger markets around the world. It means that they can have access to more capital flows, technology, cheaper imports, and larger export markets. But markets do not necessarily ensure that the benefits of increased efficiency are shared by all. Countries must be prepared to embrace the policies needed, and in the case of the poorest countries may need the support of the international community as they do so.

Economies are continually evolving and globalization is one among several other continuing trends. One such trend is that as industrial economies mature, they are becoming more service-oriented to meet the changing demands of their population. In fact, globalization is actually making this process easier and less costly to the economy as a whole by bringing the benefits of capital flows, technological innovations, and lower import prices. Economic growth, employment and living standards are all higher than they would be in a closed economy.

What is the appropriate policy response? Should governments try to protect particular groups, like low-paid workers or old industries, by restricting trade or capital flows? Such an approach might help some in the short-term, but ultimately it is at the expense of the living standards of the population at large. Rather, governments should pursue policies that encourage integration into the global economy while putting in place measures to help those adversely affected by the changes. The economy as a whole will prosper more from policies that embrace globalization by promoting an open economy, and, at the same time, squarely address the need to ensure the benefits are widely shared.

References

1. Dasgupta, P., (2022), Globalization of Law and Practices, <https://www.legalserviceindia.com> ›
2. Inan, C., (2022), From the Local to the Global: The Politics of Globalization, <https://carnegieeurope.eu> › fr.
3. Law and Globalization: a Critique of a Dialectic Relation, (2020), <https://revista.direito.ufmg.br> › article › view.
4. Law and International Economic Development - Pathways, (2022), <https://pathways.wcl.american.edu> ›
5. Lutkevich, B., (2022), What Is Globalization? Globalization Explained - TechTarget, <https://www.techtarget.com> ›
6. Michaels, R., (2022), Globalization and Law: Law Beyond the State, <https://scholarship.law.duke.edu> › cgi › viewcontent.
7. Morosini, F., (2015), Globalization and Law: Beyond Traditional Methodologies of Comparative Legal Studies and an Example from Private International Law, <https://papers.ssrn.com> › papers.
8. Vasyl, T., Oleg, D., (2019), The impact of globalization processes on the legal sphere, <https://amazoniainvestiga.info> › article › download.
9. Wang, G., (2022), International development law in the globalized world, <http://www.austlii.edu.au> › journals › JCULawRw
10. Ullrich, H., (2022), The Globalization of Economic Law | Cairn International Edition, <https://www.cairn-int.info> › ar.

PARASHKRIMI I PADISË SË RIVENDIKIMIT

Msc. Endi Kalemaj
Prof.As.Dr. Ervis Çela

Abstrakt.

¹Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi.²***Nuk mund të ngrihet padi nga një person që i mungon zotësia juridike për të vepruar.***Afati për parashkrimin e padisë, për shpalljen e pavlefshëm të veprimit juridik, është pesëvjeçar, është afat i posaçëm, në dallim nga afati i përgjithshëm i parashkrimit të padive, parashikuar nga neni 114 i Kodit civil, që është dhjetëvjeçar. Duke pasur parasysh formulimin e nenit 103 të Kodit civil, evidentojmë faktin se në këtë rast bëhet fjalë për padinë që ka të bëjë me veprimet juridike relativisht të pavlefshme, pra të anulueshme.

Instituti i parashkrimit të padisë dhe i dekadencës së të parashikohet në nenet 112-128 të kodit civil³. Poseduesi sipas parimit të së drejtës subjektive është i autorizuar të ushtroj pushtet faktik mbi sendin, ai ka të drejtën e posedimit. Posedimi nënkupton **pushtetin faktik** të një personi ndaj një sendi apo një të drejte, për dallim nga pronësia e cila nënkupton **pushtetin juridik** të një personi ndaj një sendi. Nga kjo rrjedhë se te posedimi është i nevojshëmtë ekzistoj pushteti faktik, ndërsa te pronësia pushteti juridik

Posedimi fitohet në moment kur poseduesi arriti ose po vendosi pushtetin faktit mbi atë send, pamvarsisht nga ajo se a kemi të bëjmë me aktin e përvetësimit në mënyrë origjinare respektivisht pa vullnetin e poseduesit të deritanishëm do me thënë me akte të një anshëm, ose po posedimi i është bartë në mënyrë derivative që nënkupton me vullnetin e paraardhësit respektivisht atij që e ka poseduar sendin⁴. Nga e sipërpërmendura mund të konstatojmë se fitimi i posedimit arrihet në dy mënyradhe atë në mënyrë origjinare dhe derivative.

Në nenin 115 të Kodit Civil janë paditë që parashkruhen brënda afatit kohor nga 6 muaj ne tre vite.

¹ Neni 31 I Kodit të Procedrës Civile të RESH-së.

² Neni 33 I Kodit të Procedurës Civile të RESH-së.

³ Nenet 112-128 të Kodit Civil

⁴ Çavdar, Kiril. Çavdar Kimo, fq.440, neni 173, Zakon za sopstvenost i drugi stvarni prava-komentar, objasnivanja, Shkup 2012

Në nenin 113 të Kodit Civil janë listuar paditë që nuk parashkruhen të cilat janë: a) padia për rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore, përveç përjashtimeve të caktuara në ligj b) paditë e njohjes; c) padia e pjesëtimit midis bashkëpronarëve; ç) padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë; d) paditë e tjera të parashikuara në dispozita ligjore të veçanta⁵.

Sic duket kemi që padia e rivendikimit nuk është rregulluar në nenin e mësipërm dhe, prandaj, për afatin e parashkrimit të kësaj padie, referimi bëhet në nenin 114 të Kodit Civil që parashikon, se: *“Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë”*.

Në doktrinë, padia e rivendikimit përkufizohet si padia e pronarit joposedues kundër poseduesit jopronar për kthimin e sendit. Që të ushtrohet kjo e drejtë duhet: që paditësi (ai që kërkon mbrojtje me anën e padisë) të jetë pronar i sendit që kërkon (rivendikon) dhe që i padituri (ai kundër të cilit drejtohet padia) të jetë posedues i paligjshëm isendit

Fjale kyce: *padia, afati, parashkrimi, rivendikim, parashkrim shues, bashkëpronar, legjitimiteti aktiv, pasiv, parashkrimi fitues me ose pa titull.*

Historiku mbi padinë e rivendikimit ndër vite.

Një nga aktet më të rëndësishme të asaj kohe ishte *“Statuti i Mbretërisë Shqiptare i vitit 1929”*. Ky akt do të njohë pronën private si një të drejtë kushtetuese të pakontestueshme. Në artikullin 198 të këtij statuti parashikohej se: *“E drejta e pronësisë, për çfarëdolloj pasurie që të jetë, është e padhunueshme. Pa të qenit e vërtetuar rregullisht nevoja e interesit botëror dhe pa mospagesën e vlerës së arsyeshme, sipas ligjit të posaçëm nuk mund të shpronësohet pasuria e askujt”*.

Në Statutin e Mbretërisë në artikullin 222, gjejmë këtë parashikim për të drejtën e pronësisë: *“Toka është pronë e thjeshtë (mulq) dhe për të zbatohen dispozitat e Kodit Civil. Derisa të hyjë në fuqi Kodi Civil, mbi tokat, zbatohen dispozitat ligjore të deritanishme”*. Ky akt sanksiononte pronën private duke i dhënë të drejtë subjekteve private ta zotëronin atë dhe të mos

⁵Si padi të tjera të parashkrueshme e të palistuar në këtë dispozitë, por në një dispozitë të veçantë të Kodit Civil është vetem padia për kërkimin e trashëgimit e parashikuar në nenin 351 të Kodit Civil me këtë përmbajtje: *“Padia për kërkimin e trashëgimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të parashkrimit fitues për sende të veçuara”*. Për këtë arsye, përmbajtja e nenin 351 mund të zëvendësohet përmbajtjen e pikës d) të nenit 115 të Kodit Civil

cënoheshin në të drejtën e tyre të pronësisë dhe nga ana tjetër do të gjejmë kufizime të tjetërsimit kur bëhet fjalë për pronën shtetërore.

Akti i cili shënoi një pikë kulminante në definimin dhe rregullimin e institutit të së drejtës së pronësisë në atë kohë ishte Kodi Civil i vitit 1929, akt ky i cili gjithmonë ka paraqitur vlera historike dhe studimore. K.Civil i vitit 1929, në artikullin 794 parashikonte se: *"Zotnimi asht e drejta me gëzue e me disponuar sendet pa asnjë kufizim tjetër, jasht atyne që caktohen me ligj ose me rregullore"*

Referuar dispozitave të këtij kodi, paditë për mbrojtjen e të drejtës së zotnimit ndahen në dy kategori: (i) Kur pushtetet që ka zotënuesi mbi sendin i kontestohen (kundërshtohen) prej një të treti tërësisht ose pjesërisht dhe (ii) kur i treti pretendon mbi sendin një të drejtë reale të plotë (zotnim) ose të pjesshëm (servitut), ligji i akordon zotnuesit mjetet e mbrojtjes së zotnimit të tij.

Për prapësimin e pretendimit të të tredit mbi krejt zotënimin e sendit, ligji njihte : (i) padinë e rivendikimit (rei vindiciatio); për prapësimin e pretendimit të të tredit për një të drejtë të pjesshme mbi sendin, ligji i njihte zotëruesit (ii) padinë mohuese ose negatore (actio negotatoria). Padia e rivendikimit sipas këtij kodi kishte për qëllim njohjen e të drejtës së zotnimit dhe kthimin e sendit prej atij që e mban pa të drejtë. Padia mohuese ose negatore ka për objekt mohimin e të drejtave që pretendohen mbi sendin e huaj dhe deklarin se sendi i zotnuar prej paditësit është i lirë nga çdo kufizim (uzufukt, servitut).Funksioni i këtyre padive nuk është vetëm për të mbrojtur të drejtën e zotnimit, por edhe të drejtën e posedimit, prandaj këto dy padi i shërbejnë si zotnuesit ashtu edhe poseduesit, pasi kanë për qëllim marrjen e masave të përkohshme dhe preventive kundrejt ngacmimeve të të tretëve, pa prekur themelin e të drejtës.

Në nenin 2034 të **Kodit tonë Civil të parë në Shqipëri**, në atë të Mbretërisë Shqiptare, që hyri në fuqi në vitin 1929 u parashikua, se: *"Por kur ka dispozitë të kundërt, gjithë paditë reale ashtu dhe personale parashkruen mbas tridhjetë vjetëve, pa qënë i obliguem pretenduesi i parashkrimit me paraqitë titull dhe pa mos me mundë me iu kundërdrejtue këtij mungesa e mirëbesimit."* . *E drejta e zotnimit nuk humbë pra me mospërdorimin e kështu zotnuesi, edhe sikur mos t'a ketë përdorë gjan e vet për njëqind vjet, nuk e humbetë të drejtën e ushtrimit të padisë së rivendikimit deri sa i padituri nuk e ka fitue me zotnimin me parashkrim vehtësimtar."* Pra, në atë periudhë padia e rivendikimit prej doktrinës apo edhe prej jurisprudencës konsiderohej e paparashkrueshme, përse kohë që dikush tjetër nuk fitonte pronësinë për të njëjtën pronë me parashkrim fitues, sipas afateve të posedimit të pashqetësuar, të parashikuara në ligj.

Në vitin **1946 u miratua Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë**, që solli ndryshime në rendin ekonomik - shoqëror në vendin tonë, E cila në nenin 7, kapitullin II të saj parashikonte se, *"Në Republikën Popullore të Shqipërisë mjetet e prodhimit përbëhen prej pasurisë së përbashkët të popullit që gjendet në duart e shtetit, prej pasurisë së organizatave kooperativiste popullore dhe prej pasurisë së personave privatë, fizikë ose moralë"*. Në dispozitat të Kodit Civil u parashikuan standarte të ndryshme në mbrojtje të së drejtës së pronësisë shtetërore,

kooperativiste dhe të personave privatë, duke siguruar një mbrojtje të veçantë për dy të parat dhe duke vijuar me shkallëzime edhe ndërmjet tyre, me përparësi të parën.

Në nenin 12 të kësaj Kushtetutë thuhet se: “Toka u takon ayre që e punojnë. Caktohet me ligj kur nje institucion ose një person që nuk e punon token mund të mbetet zot i kësaj toke dhe në ç’masë”. E njëjta frymë dhe ideologji do të përshkonte dhe K.Civil të vitit 1955. Subjekte të së drejtës së pronësisë socialiste ishin shteti dhe organizatat kooperativiste-shoqërore, kurse subjekte të pronësisë private ishin personat fizikë.

Dekreti nr.2083, datë 06.07.1955 “Mbi Pronësinë”, aprovuar me ligjin nr.2251, datë 04.04.1956 (hyrë në fuqi më datë 01.09.1955). Në pronësi të personave privatë mund të ishin si pasuri të paluajjtshme vetëm banesat. Këto banesa privatët i patën përfituar ose (i) nëpërmjet blerjes nga shteti, ose (ii) ishin banesat vetjake që kishin mbetur si të tilla nga shtetëzimet që kishte bërë shteti i kohës

Neni 76 i Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil të vitit 1955 për paparashkrueshmërinë e padisë së rivendikimit për pasurinë shtetërore dhe kooperativiste, duke parashikuar shprehimisht se: “Nuk parashkruhet e drejta e padisë së shtetit, kooperativave dhe organizatave të tjera shoqërore për kërkimin e pasurisë së tyre të luajjtshme e të paluajjtshme nga cilido posedues i paligjshëm. E drejta e padisë së shtetit për kërkimin e pasurisë shtetërore nuk parashkruhet as kundrejt kooperativave dhe organizatave të tjera shoqërore...”

Arësyeja për mosparashkrimin e padisë së rivendikimit të shtetit, qëndronte ***për rendësinë e madhe e të veçantë që kishte prona shtetërore në tërësinë e sistemit të atëhershëm ekonomik.*** Referuar ligjit të kohës ishte pronë private çdo gjë që nuk ishte e ndaluar të ishte në pronësi të personave privatë. Prona shtetërore mbrohej nga çdo transferim apo kalim i paligjshëm i pasurisë së saj në pronësi të kooperativave bujqësore, apo personave fizik. Prona e “harruar”, domethënë në një pronë pa zot, e cila në bazë të nenit 49⁶të Dekretit mbi pronësinë, kalonte përsëri në pronësi të shtetit.

Në vijim, neni 82: ***Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, e drejta e padisë parashkruhet: b) me kalimin e tre vjetëve për konfliktet midis privatëve ose midis privatëve dhe institucioneve, ndërmarjeve dhe organizatave shtetërore, kooperativiste dhe shoqërore, me përjashtim të konflikteve në lidhje me të drejtat mbi pasuritë e paluajjtshme, për të cilat e drejta e padisë parashkruhet në kalimin e 6 vjetëve.***

⁶Neni 49 i Dekretit mbi Pronësinë: *Sendet pa zot kalojnë në pronësi të shtetit. Sendet pa zot janë ato që nuk kanë pronar ose pronari i të cilave ka hequr dorë nga pronësia si dhe ato, pronari i të cilave ka humbur me parashkrim të drejtën që t’i kërkojë nga poseduesi i paligjshëm dhe pronësinë e të cilave nuk e ka fituar ndonjë person tjetër me parashkrim fitues. Kalimi i sendeve pa zot në pronësisë të shtetit bëhet me vendim të gjykatës, përveç rastit të parashikuar në nenin 27*

Në vitin *1976 u miratua Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë që hyri në fuqi më 1 Janar 1977*, duke sjellë ndryshime të mëtejshme në rendin ekonomiko-shoqëror, ku e gjithë toka bëhej në pronësi të shtetit dhe u jepej pa shpërblim, në përdorim shoqëror ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore, kooperativave bujqësore dhe organizatave shoqërore dhe në përdorim vetjak shtetasve.⁷Të gjitha aktet e mësipërme të kohës nuk bënë gjë tjetër veçse çuan në nxjerrjen e tokës jashtë qarkullimit civil. Por ajo që përfundimisht e nxorri tokën nga qarkullimi civil ishte Kushtetuta e 1976.

Sipas **nenit 19** të Kushtetutës e gjithë toka u shpall pronë shtetërore. Në këtë nen sanksionohej se “Tokë u jepet në përdorim shoqëror ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore, kooperativave bujqësore dhe organizatave shoqërore, si dhe në përdorim vetjak shtetasve”

Më datë *1.1.1982 hyri në fuqi Kodi Civil, që iu përshtat më mirë rendit ekonomik të lartëpërmendur*. Sipas parashikimeve të këtij Kodi, çdo pronë në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, ishte në pronësi të shtetit, të kooperativave bujqësore dhe të personave të veçantë. Prona socialiste përbëhej nga prona shtetërore dhe nga prona kooperativiste në bujqësi. “Prona shtetërore i përket gjithë popullit dhe është forma më e lartë e pronës socialiste”. Shteti ishte pronar i vetëm i të gjithë pronës shtetërore. Përsa i përket institutit të parashkrimit të padisë ndodhën disa ndryshime, prej të cilave spikat zvogëlimi i mëtejshëm i afatit të parashkrimit të padisë së shtetasve dhe vijimi i mosparashkrimit të padisë së shtetit në mbrojtje të pronës shtetërore. Pronë e shtetit ishte edhe çdo pasuri tjetër që krijohet në sektorin shtetëror ose që shteti e fitonte sipas ligjit.

Neni 59 i Kodit Civil shprehet, se: “Një e drejtë që nuk ushtrohet brenda afateve të caktuara në ligj, nuk mbrohet me anë të padisë nga gjykata ose nga organi kompetent. Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe afati i parashkrimit të padisë është: a) një vit e gjysmë për paditë ndërmjet personave juridike; b) tre vjet për paditë ndërmjet personave juridike dhe shtetasve si dhe ndërmjet vetë shtetasve...”

Nuk i nënshtrohen parashkrimit sipas nenit 63 të Kodit Civil: a) padia e shtetit për kërkimin e pronës shtetërore që mbahet në mënyrë të paligjshme nga një kooperativë bujqësore ose organizatë shoqërore ose nga një shtetas; b) padia e kooperativës bujqësore dhe e organizatave shoqërore për kërkimin e pronës së tyre që mbahet në mënyrë të paligjshme nga shtetasit...

Në vitin 1990 u rrezua regjimi diktatorial i kohës dhe iu hap rruga pluralizmit politik, qeverisjes demokratike si dhe sanksionimit të ekonomisë së lire të tregut dhe pronës private.

Datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, u sanksionua e drejta e individit për të gëzuar pronën private. Ky ligj vendosi një rend të ri ekonomik, dhe kalimin përfundimisht

⁷Neni 19 i Kushtetutës së vitit 1976

nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në *parimet e tregut të lirë*. Shitja dhe blerja e tokës bujqësore fillimisht u ndalua me ligj. Toka bujqësore u jepej në pronësi ose në përdorim personave fizikë dhe juridikë vendas pa shpërblim.

Më datë **1.11.1994 hyri në fuqi Kodi Civil aktual**, në të cilin janë bërë disa ndryshime., afati i parashkrimit të padisë së rivendikimit nuk përcaktohet në ndonjë nen të Kodit, prandaj për afatin e parashkrimit të kësaj padie, referimi bëhet në nenin 114 të Kodit Civil, *Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë.*⁸Një nga mënyrat e ligjshme të fitimit të pronësisë është edhe kontrata e shitjes si veprim juridik i dyanshëm. Ajo është e vlefshme edhe për kalimin e pronësisë së sendeve nga shteti tek individ, duke shërbyer kështu si mjet juridik për fitimin e pronësisë private në mënyrë të prejardhur nga e drejta e pronësisë shtetërore.⁹

Në vendimin nr.614.datë20/03/2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka konstatuar se padia e rivendikimit është mjet juridik për mbrojtjen e së drejtës subjektive dhe si e tillë është garanci ligjore për mbrojtjen dhe rivendosjen gjyqësisht të të drejtave civile të shkelura dhe ***sipas këtij vendimi nuk i nështrohet parashkrimit shues***. Në vendimin Nr.5,të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në të cilin janë argumentuar qartë arsyet e paparashkrueshmërisë të kësaj padie,arsye që gjenden në vetë natyrën juridike të pronësisë. Nëse do të pranohej se padia e rivendikimit do të parashkruhet,mund të vendosemi para situatës kur pronari të mos kishte mundësi të ushtronte të drejtat e tij mbi sendit për shak të kalimit të afatit.

Legjislacionet e vendeve të tjera për parashkrimin apo jo të padisë së rivendikimit

Në Kodin Civil Italian gjëndja e afatit të padisë së rivendikimit është shprehur në nenin 948 § III,në të cilin parashikohet: “Padia e rivendikimit nuk parashkruhet, përveç efekteve të fitimit të pronësisë nga ana e të tjerave me parashkrim fitues.”¹⁰

Në Kodin Civil Francez afati i parashkrimit të padisë së rivendikimit, me ndryshimet e bëra në nenin 2227, nëpërmjet ligjit nr. 2008-561, parashikon: “E drejta e pronësisë është e paparashkrueshme. Në varësi të kësaj rezerve, veprimet e pasurive të paluajtshme janë të parashkrueshme për tridhjetë vjet nga dita në të cilën mbajtësi i një të drejte i ka ditur ose duhet t’i

⁸“Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë.”

⁹ Vendimi nr. 04, datë 08.04.1994 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁰Neni 948/III Azione di rivendicazione: “L'azione di rivendicazione non si prescrive, salvi gli effetti dell'acquisto della proprietà da parte di altri per usucapione.”

ketë ditur faktet që i lejojnë atij ta ushtrojë atë.”¹¹

Objektinë padinë e rivendikimit

Më padine e rivendikimit pronari i cili është zhveshur nga posedimi mbi sendin kërkon, detyrimin e të paditurit që ta njoh pronar mbi sendin objekt konflikti dhe detyrimin e të paditurit që ti kthej posedimin e sendit të tij.

Të dyja këto kërtime ekzistojnë në padinë e rivendikimit, por mund të ndodh në raste të caktuara kërkitimi i parë të mos ekzistoj në këtë padi dhe kjo është situatë kur i padituri e njeh si pronar i sendit paditësin por nuk pranon ti kthej posedimin e sendit, duke pretenduar arsye që janë të bazuara (duke u bazuar në kontrata psh, qeraje etj, në vendime gjyqësore) ose duke mos pretenduar asnjë arsye të cilat janë të bazuara.. Objekt posedimit mund të jetë çdo send në qarkullim, pra objekt i posedimit nuk mund të jetë ajo që nuk është send dhe nuk është në qarkullim dhe mbiatë send është e mundur pronësia, ose sendi që drejtë të jetë sendi ose detyrim që ka të bëjë me shfrytëzimin e sendit, në atë send është i mundur edhe posedimi. Pra mund të kërkojnë vetëm ato sende materiale të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të jenë objekt pronësie. Subjekt i posedimit ose poseduesi mund të jetë çdo person fizik, juridik¹². Kur kemi të bëjmë me personin juridik, atëherë duhet që në fillim të potencojmë se edhe shteti mund të paraqitet si subjekt i posedimit.

Legjitimimi aktiv dhe pasiv në padinë e rivendikimit

Përmbushjen e kushtit që si palë paditëse në gjykim të paraqitet personi që ka të drejtën për të ngritur padi dhe si i paditur personi që ka cënuar të drejtën e paditësit.

Që të ngreht padina e rivendikimit duhet të plotësohen disa kushte të përcaktuara nga ligji, të cilat janë determinante. Kushtet që duhet të plotësojë paditësi në mënyrë që të pranohet padia e rivendikimit e ngritur prej tij, përbën atë që quhet legjitimim aktiv dhe pasiv i paditësit në padinë e rivendikimit.

Kushti parë që duhet të plotësojë paditësi në padinë e rivendikimit është që ai duhet të jetë pronar i sendit që kërkon të rivendikoj ose të kthejë posedimin e tij.¹³ Padinë e rivendikimit ***mund ta ngrejë vetëm pronari i sendit*** dhe askush, tjetër. Me pronarin e sendit barazohet edhe bashkëpronari në rastin e sendeve në bashkëpronësi.¹⁴ Kjo e drejtë i takon vetëm pronarit të sendit, sepse ai është i vetmi person që ka interes

¹¹Neni 2227: “*Le droit de propriété est imprescriptible. Sous cette réserve, les actions réelles immobilières se prescrivent par trente ans à compter du jour où le titulaire d'un droit a connu ou aurait dû connaître les faits lui permettant de l'exercer.*”

¹² Klariç, P& Vedriš, M. Gragjansko pravo fq.198 Zagreb 2009.

¹³ Neni 296 kodi civil

¹⁴ Neni 296\2

direkt dhe personal në ngritjen e kësaj padie, pasi ai është personi që gëzon të drejtën subjektive të pronësisë mbi sendin dhe të cilit i është cënuar kjo e drejtë në mënyrë të paligjshme nga i padituri. Duhet të kemi një cënim të lindur dhe aktual, pasi një interes i pasigurt që i përket të ardhmes, nuk mund të parashikohet. Padia e rivendikimit mund të ngrihet vetëm pasi pronarit t'i jete hequr posedimi mbi sendin dhe jo nëse ai mendon se një gjë e tillë do të ndodh në të ardhmen.¹⁵

Nënkupton të drejtën për të kërkuar mbrojtje në gjykatën kompetente ku titullari i posedimit e ka nën posedim sendin, respektivisht të drejtën sendore të posedimit mbi sendin. Ai është personi i cili deri në momentin e pengimit ose marrjes së posedimit ka qenë posedues i rregullt.

Dhënia e së drejtës cdo bashkëpronari për të kërkuar sendin e përbashkët përputhet plotësisht me natyrën e bashkëpronësisë ku mbi të njëjtin send ushtrojnë të drejtën e pronësisë

disa persona njëkohësisht, ku *një nga të drejtat më të rëndësishme që ka cdo bashkëpronar mbi sendin e përbashkët është dhe e drejta për të kërkuar këtë send*¹⁶.

Si përjashtim nga rregulli I përgjithshëm padia e rivendikimit mund të ngrihet edhe nga jo pronari sendit. Këto raste janë *Së pari*, në rastin e sendeve të cilat janë *në pronësi të shtetit në pergjithësi*, subjekti qëduhet të ngrejë padinë e rivendikimit për kthimin e posedimit të këtyre sendeve shtetit, sektori që cenohet dhe preket është Ministria e Financave. *Së dyti*, është *kreditorit pengmarrës*¹⁷.¹⁸ Sipas nenit 117 të Kodit Civil “*Afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë*”.

Nënenin 104 të Kodit civil përcakton momentet nga i cili fillon afati për ngritjen e padisë:

- Afati për ngritjen e padisë për veprimet juridike të kryera nga persona të cilëve u është hequr ose kanë pasur zotësi juridike të kufizuar për të vepruar, fillon ngadita që këta persona janë bërë madhorë ose u është kthyer zotësia për të vepruar.
- Për veprime juridike të kryera me mashtrim, kanosje ose lajthim, fillon nga dita që mashtrimiose lajthimi janë zbuluar, ose kanosja ka pushuar, por, në çdo rast, jo më shumë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik.
- Në raste të tjera, fillon që nga dita kur është kryer veprimi juridik.

Legjitimi pasiv në padinë e rivendikimit

¹⁵ Cit., Tafaj F., & Tusha V., “Procedura civile” f. 21-34.

¹⁶ Neni 200 I kodit civil pika D...

¹⁷ Neni 548 K.c.

¹⁸ Neni 117 I Kodit Civil RESH-së

I paditur është personi i cili e ka kryer pengimin ose marrjen e posedimit¹⁹. Nënkuptojmë se është ai person i cili ka bërë pengimin, shqetësimin apo marrjen e posedimit .

Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e zotëron sendin në bazë të një shkakut pra në bazë të ligjit. Posedimi është i paligjshëm, kur i padituri e mban sendin në posedimin e tij, qoftë edhe të përkohshëm, pa patur një shkak të ligjshëm ose pasi shkak i ligjshëm ka rënë.²⁰

Duhet ta ngrejë pikërisht ndaj personit i cili e ka zhveshur nga posedimi i sendit, ku sht i cili njihet me emrin legjitim pasiv i paditësit në këtë padi. Pra, legjitimi pasiv i paditësit në padinë e rivendikimit ka të bëjë ***paditësi duhet të ngrejë padinë pikërisht ndaj personit ose personave që kanë zhveshur në mënyrë të jashëligjshme nga pronësia (posedimi i sendit)***, dhe paditësi duhet që të ngrej padinë ***ndaj personit që e ushtron posedimin mbi sendin e tij në momentin e ngritjes së padisë***, sepse mund të kemi që personi i cili e ka zhveshur nga posedimi paditësin të mosjetë ai që e posedon sendin në momentin e ngritjes së padisë, por poseduesi të jetë një person tjetër. ***Duhet që të provohet se i padituri është posedues i paligjshëm në momentin e ngritjes së padisë dhe kjo plotëson legjitimitimin pasiv në ngritjen e padisë***²¹ dhe nuk ka ndryshi midis tyre nëse është me mirëbesim apo me keqëbesim.

Të provuarit në padinë e rivendikimit

Kjo ceshtje zgjidhet duke u bazuar në rregullat mbi barrën e provës në një proces gjyqësor civil ku pala që pretendon një të drejtë është e detyruar që në përputhje me ligjin të provoj faktet mbi të cilat bazon pretendimet e saj²². Paditësi duhet të provojë nëpërmjet dokumentave shkresore se është pronar apo bashkëpronar i sendit individualisht të përcaktuar.

Paditësi duhet të jetë pronar i sendit në kohën e ngritjes së padisë: pala paditëse duhet të provojë ligjshmërinë e titullit të pronësisë, duke paraqitur mënyrën e fitimit të saj original ose derivativ, mënyres me të cilin ai është bërë pronar i sendit që kërkon të rivendikojë.²³

Duhet të provojë para gjykatës se sendin individualisht të përcaktuar ai nuk e posedon dhe gëzon tërësisht apo pjesërisht. Paditësi duhet të tregojë realisht se ai e ka humbur posedimin e sendit në mënyrë të paligjshme duke paraqitur, denoncimit, provat me ekspertetj. Në rast se sendi

¹⁹ Klariç, P & Vedriš, M. Građansko pravo fq.220-221 Zagreb 2009.

²⁰ Në nenin 296 të Kodit Civil, parashikohen llojet e posedimit të ligjshëm dhe të paligjshëm: “Posedimi i personit jo pronar mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm. Posedimi është i ligjshëm kur poseduesi e ka posedimin nga pronari, në bazë të një veprimi juridik, në bazë të ligjit ose të një akti administrativ. Në të gjitha rastet e tjera posedimi është i paligjshëm.”

²¹ Legjitimiteti aktiv dhe ai pasiv janë dy element të cilët nuk duhet të mungojnë në padinë e rivendikimit, nëse njëri prej tyre mungon padia do të rrëzohet.

²² Neni 12 I Kodit të Procedurës Civile

²³ Neni 199 i K.Pr.C rregullon institutin e kalimit procedural për shkak të vdekjes apo mbarimit të personit juridik, parashikon “Kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj”. Neni 200 i K.Pr.C rregullon institutin e kalimit procedural, parashikon “Kur gjatë zhvillimit të gjykimit e drejta që është në konflikt i kalon një personi tjetër me akt ndërmjet të gjallëve ose me titull të posaçëm, procesi gjyqësor vazhdon midis po atyre palëve që ishin në fillim”.

që kërkohet të rivendikohet është shkatërruar, padia e rivendikimit do të rrëzohet, sepse mungon objekti. Kolegji Civil i Gjykatës të Lartë në një nga vendimet e tij njëhësuese arsyeton se, ashtu si padia e kërkimit të sendit nuk parashkruhet edhe kërkimi i dëmshpërblimit për shkak të shkatërrimit të sendit që kërkohet të rivendikohet, nuk mund të parashkruhet.²⁴

“Poseduesi në mirëbesim, nuk detyrohet të shpërblejë pronarin për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit për çdo shkak tjetër, por pas kësaj dite kur ai vjen në dijeni se posedimi i tij është i paligjshëm do të përgjigjet për frutat e vjela ose që duhet të kish vjelë, duke vepruar me përkujdesje deri në kohën e kthimit të sendit, për shpërblimin për përdorimin e sendit, si dhe për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit për faj të tij”.²⁵

Pala paditëse nuk mundet të ngrejë padinë e rivendikimit, për të kërkuar lirim dhe dorëzimin e një sendi që nuk ekziston më fizikisht. Për rrjedhojë pala paditëse të vetmin mjet juridik që ka në dispozicion për të ushtruar ka qenë kërkimi pasuror i vlerës ekuivalente të pronës së shpronësuar de facto.

Në nenin 9 i kodit të Procedurës civile i cili përcakton se palët kanë për detyrim të paraqesin faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Paditësi në padinë e rivendikimit është i detyruar që të provojë se është pronar i sendit që kërkon të rivendikojë në momentin e ngritjes së padisë, pra të provojë legjitimitimin aktiv të tij, si dhe është i detyruar që të provojë se është pikërisht i padituri, cili e ka zhveshur në mënyrë të paligjshme nga posedimi i sendit në pronë të tij, pra të provojë legjitimitimin pasiv të tij. Paditësi në këtë padi duhet të provojë faktin se ekziston një e drejtë nëmer të tij që është e drejta e pronësive si dhe rrethanat e faktit të cilat tregojnë se kjo e drejtë e tijë në rastin konkret është cënuar nga i padituri. Në rastet kur paditësi e ka fituar pronësinë mbi sendin që rivendikon në një nga mënyrat e prejardhura të fitimit të pronësië çështja e provimit bëhet shumë e vështirë kjo sepse kur një gjë të tillë e kundërshton i padituri, është i detyruar që të provojë jo vetëm pronësinë e tij por edhe pronësinë e personit që ka fituar sendin.

Kur mund e ngrihet padia e rivendikimit.

Padia e rivendikimit duke qene mjeti kryesor juridik civil për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë së sendit mund të ngrihet kurdoherë që pronarit të ligjshëm i cënohet e drejta.

1. Kur i padituri e ka zhveshur nga posedimi i sendit pronarin duke e pushtuar sendin si dhe duke e mbajtur atë pa asnjë shkak të ligjshëm apo titull.

2. Kur i padituri ka patur sendin në posedim të ligjshëm por refuzon tja kthejë pronarit megjithëse është i detyruar që ta bëjë një gjë të tillë.

3. Kur veprimi juridik mbi bazën e të cilit i padituri ka fituar posedimin e sendit është konstatuar i pavlefshëm apo është shpallur i pavlefshëm.

²⁴ Për më tepër shiko Vendimin nr.00-2017 (205), datë 04.04.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës të Lartë.

²⁵Neni 297 Kodi Civil

4. Kur posedimi i është hequr pronarit dhe i ka kaluar një personi tjetër mbi bazën e një akti administrativë të paligjshëm.

5. Kur pronarit i është hequr posedimi i sendit duke i kaluar një personi tjetër e mbi bazën e një akti administrativë, ekzekutimi i të cilit është I paligjshëm.

Sa i përket jurisprudences në Vendimin Nr. 5 të Gjykatës së Lartë të 2011 saktësohet se mospërdorimi i sendit nga pronari është shprehje e lirisë që njihet atij, është një manifestim i gjerësisë së tagrave që i përkasin pronarit. Në këtë vendim është qartësuar se e drejta e pronësisë nuk mund të humbasë nga mospërdorimi, edhe sikur pronari të mos t'ua ketë përdorur sendin e vet, për një kohë të gjatë. Pronari nuk e humbet të drejtën e ushtrimit të padisë së rivendikimit derisa i padituri nuk e ka fituar pronësinë me parashkrim fitues.²⁶ Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se paparashikueshmëria e padisë së rivendikimit buron nga karakteri i përhershëm dhe i qëndrueshëm i pronësisë, që do të thotë se pronësia mbetet e tillë edhe kur ndoshet në posedimin e cdo personi të tretë.²⁷

Kolegjet e Bashkuara, në vendimin e tyre argumentojnë:

1. E drejta e pronësisë është një e drejtë absolute, e pa kufizuar në kohë dhe ushtrohet nga titullari në çdo kohë. Të pranosh që e drejta e pronësisë humbet me anë të parashkrimit shues do të thotë që ushtrimit të kësaj të drejte t'i vesh kufij kohorë dhe ta kufizosh të drejtën e pronarit me kufij të caktuar kohorë, gjë që do të vinte në kundërshtim me konceptin e vetë të drejtës së pronësisë. 2. E drejta e pronësisë është një e drejtë me karakter të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, çka do të thotë se ajo ekziston në çdo kohë dhe mos gëzimi i sendit nga pronari apo mos ushtrimi i kësaj të drejte për një periudhë të caktuar nga pronari, pavarësisht nga periudha, nuk sjell shuarjen e të drejtës së pronësisë. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit buron nga karakteri i përhershëm dhe i qëndrueshëm i pronësisë, që do të thotë se pronësia mbetet e tillë edhe kur ndodhet në posedimin e cdo personi të tretë, që nuk e ka fituar pronësinë nëpërmjet veprimeve juridike të tjetërsimit apo me ndonjë mënyrë tjetër të ligjshme.

3. Parashkrimi fitues në kushtet e përcaktuara në ligj mund të sjellë lindjen ose fitimin e së drejtës së pronësisë, ndërsa parashkrimi shues për asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të sjellë humbjen e së drejtës së pronësisë, sepse ai është lidhur ngushtë me humbjen e të drejtës së padisë dhe jo me humbjen e së drejtës së pronësisë. Parashkrimi fitues (me titull ose pa titull) është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, parashikuar në nenet 168 dhe 169 të Kodit Civil. Nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këto dispozita, padia e rivendikimit rrëzohet, jo për shkak të parashkrimit shues, por pasi kjo mënyrë fitimi pronësie përbën shkakun ligjor që pronari i mëparshëm i sendit humbet të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin. Edhe në rastet kur një person nuk e përdor sendin për një periudhë mbi 20 vjet dhe pronësinë mbi këtë send e fiton një person tjetër për shkak të plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 169 të Kodit Civil, personi i parë

²⁶ Po aty,

²⁷ Vendimi nr. 5, dt 31.05.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

e ka humbur pronësinë e tij mbi sendin jo për shkak të parashkrimit shues, ose për shkak të mospërdorimit të sendit mbi 20 vjet, por për shkak se pronësinë mbi këtë send e ka fituar personi tjetër me anë të parashkrimit fitues.

Në argumentim sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se në raste të tilla nuk është parashkrimi i së drejtës së padisë shkak i rrëzimit të padisë, por është fakti se paditësi ka humbur të drejtën e tij të pronësisë për shkak se i padituri ka fituar të drejtën e pronësisë mbi sendin me parashkrim fitues.

37. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit ka kuptimin që ajo mund të ngrihet kurdoherë pavarësisht nga periudha që ka kaluar që nga çasti kur pronari i sendit nuk e ushtron posedimin mbi të, dhe aq kohë sa e drejta e pronësisë mbi këtë send të mos ketë kaluar për ndonjë shkak tjetër ligjor tek ndonjë subjekt tjetër, si në rastin e parashkrimit fitues. Referuar çështjes, dhe për nevojat e zgjidhjes së saj, mjaftohemi me konstatimin e qënies së një mundësie të tillë, duke mos i hyrë diskutimit të kushteve që duhet të plotësohen për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull apo pa titull

37.1. Paparashkrueshmëria e padisë së rivendikimit, gjithashtu e ka burimin në faktin se pushteti që përbën elementin bazë të së drejtës subjektive të pronësisë, ashtu siç është përkufizuar kjo e drejtë në nenin 149 të Kodit Civil përjashton çdo pushtet të njëjtë me këtë që ka për objekt të njëjtin send.

38. Këto arsye janë plotësisht të mjaftueshme për të vlerësuar se padia e rivendikimit nuk i nënshtrohet parashkrimit shues. “Da lege lata” ky qëndrim duhet pranuar sepse në themel merr parasysh kushtet objektive sociale, i përshtatet më mirë natyrës juridike të së drejtës së pronësisë dhe nuk vjen në kundërshtim me nenet 112, 114 dhe 149 të Kodit Civil. Megjithatë “da lege ferenda”, kur në legjislacion nuk ka ndonjë dispozitë që të parashikojë shprehimisht parashkrimin ose jo të padisë së rivendikimit, nisur nga konsideratat e mësipërme, vlerësojmë se nuk mund të parashkruhet e drejta e pronarit jo posedues për të kërkuar sendin nga çdo posedues apo mbajtës jo pronar²⁸.

Mospërdorimi i sendit nga pronari është shprehje e lirisë që i njihet atij, është një manifestim i gjerësisë së tagrave që i përkasin pronarit. Edhe nëse sendi ne pronësi nuk përdoret, ky është pjesë e tagrave të pronarit.

Nëse do të pranohej që padia e rivendikimit parashkruhet, mund të vendoseshim para situatës kur pronari të mos kishte mundësi të ushtronte të drejtat e tij mbi sendin për shkak të kalimit të afatit, ndërsa poseduesit të sendit në keqbesim do t’i krijohesh mundësia për t’a gëzuar i qetë sendin, i pa shqetësuar nga pronari, i cili do të ishte në pamundësi për të vepruar për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit shues.

²⁸Nga praktika e Gjykatës së Lartë, ‘Drejtësia Popullore’ Nr.3/1964, faqe 109

Sigurisht që për aq kohë sa e drejta e pronësisë në dy format kryesore që njeh Kodi Civil nuk është shuar në emër të pronarit/ve, për aq kohë sa ende nuk është fituar në mënyrë të ligjshme nga poseduesi jo pronar, padia e kërimit të sendit nuk parashkruhet, çka do të thotë se mund të kalojnë shumë vite dhe sërish pronari ka të drejtë ta ngrejë një padi të tillë. Mos parashkrueshmëria e padisë së rivendikimit njihet edhe nga legjislacioni francez dhe ai italian²⁹.

Ka shumë argumente që nxjerrin në përfundimin se padia e rivendikimit nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Një argument shumë i rëndësishëm është fakti se e drejta e pronësisë është një e drejtë e cila ekziston në cdo kohë dhe vazhdon që të ushtrohet në cdo kohë, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë nga pronari. Kemi dhe një element shumë i rëndësishëm lidhet me natyrën e të drejtës së pronësisë si një e drejtë reale dhe absolute. Kjo e drejtë detyron që personat e tretëve që kurdoherë dhe në cdo kohë të respektojnë të drejtën e pronësisë së pronarit mbi sendin.³⁰ Nga karakteri absolut dhe real i të drejtës së pronësisë rezulton se pronari ka të drejtë që ta ushtrojë në cdo kohë dhe vazhdimisht të drejtën e pronësisë mbi sendin e tij, për pasojë ka të drejtë që po në cdo kohë ta ngrejë padinë e rivendikimit. Padia e rivendikimit ka karakter njohës dhe detyrues njëkohësisht. Fakti që kjo padi ka karakter detyrues dhe rezulton nga vetë përmbajtja e nenit 96 të Kodit Civil, i cili percakton se: "Pronari ka të drejtë që të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga cdo posedues ose mbajtës". Karakteri njohës i kësaj padie rezulton nga vetë natyra e saj, si dhe pretendimi që mund të ketë padituri në këtë padi. Pra, sic vihet re rezulton që kjo padi mund të ngrihet vetëm nga pronari i sendit.

³¹ Pra, duhet theksuar se padia ka karakter fakultativ, në kuptimin që pronari i sendit që është zhveshur nga posediminë në mënyrë të paligjshme është i lirë të ngrejë ose jo padi në gjykatë, pasi nuk mjafton vetëm shkelja e një të drejtë subjektive për t'a ngritur padinë, por dhe vullneti i personit të cënuar. Në bazë të nenit 114 të K. Civil është një qëndrim i gabuar për sa analizuam më lart. Padia e kërimit pasuror të kompensimit të vlerës ekuivalente të sendit të shpronësuar de facto lind si pasojë e pamundësisë të ngritjes së padisë së rivendikimit, për shkak se sendi është humbur, shkatërruar apo nuk mundet të kthehet për shkaqe të ligjshme, sipas parashkrimit të nenit 297 të Kodit Civil. Në këto raste padia e kompensimit me vlerën ekuivalente të sendit, nuk është gjë tjetër veçse mjeti alternativ i mbrojtjes së të drejtës kushtetuese dhe themelore të pronësisë, në kushtet e pamundësisë së ngritjes së padisë së rivendikimit. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se, edhe për shkak të rregullimit ligjor të njëjtë në dispozitat e Kodit Civil që normojnë mbrojtjen e pronësisë me padinë e rivendikimit, regjimi juridik i padisë së rivendikimit do të ndjekë edhe regjimin juridik të padisë që rrjedh nga pamundësia e ushtrimit të saj, konkretisht padisë së kompensimit të vlerës

²⁹ Gjithashtu në bazë të neni 2227 të Kodit Civil Francez dhe nenit 948§3 të Kodit Civil Italian, padia e kërimit të sendit është e paparashkrueshme.

³⁰ Ardian Nuni, Luan Hasneziri, E Drejta Civile II, fq. 426-428.

³¹ <http://ëëë.doktoratura.unitir.edu.al/ep-content/uploads/2018/06/VALBONA-ALIKAJ2.pdf>

ekuivalente të pronës, e cila për shkaqe të parashikuara nga neni 297 i Kodit Civil nuk mundet të kthehet fizikisht.³²³³

Sic është përmendur dhe më lart padia e rivendikimit është një padi me karakter pasuror, dhe si rregull të gjitha paditë me karakter të tillë nënshtrihen afateve të parashkrimit.³⁴ Afati i parashkrimit është koha e caktuar nga ligji brenda të cilës titullari i të drejtës së cënuar mund të kërkojë me anën e padisë mbrojtjen ose rivendosjen e të drejtës së tij subjektive. Sipas zgjatjes së kohës dallojmë: afatet e përgjithëshme (ose të zakonshme) dhe afatet e posacme të parashkrimit. Në ligj është përcaktuar se vetëm për paditë që nënshtrihen afateve të parashkrimit, përcaktohet se kur fillon të ecë ky afat. Kur kemi të bëjmë me një padi të paparashkrueshme nuk mund të ketë fillim apo mbarim të afateve të parashkrimit, pasipadia mund të ngrihet në çdo kohë. Në vështirësi të neneve 112, 113, 116, 119, 168 të Kodit Civil si dhe të gjitha rregullave të tjera të përgjithëshme si dhe qëndrimin e mbajtur nga një pjesë e doktrinës se padia e rivendikimit i nënshtrihet parashkrimit shues sic do padi tjetër me karakter pasuror sipas rregullave të përgjithëshme të Kodit Civil, dhe ku parashikohet një afat parashkrimi 10 vjeçar. Padia e rivendikimit e parashikuar nga Kodi Civil në fuqi i nënshtrihet parashkrimit shues, ashtu si dhe padia e rivendikimit e parashikuar nga Kodi Civil i vitit 1982. Me plotësimin e afatit të parashkrimit ajo është parashkruar, çka do të thotë se parashkruhet e drejta subjektive e personit për të kërkuar të drejtat e tij lidhur mbi sendin.

Fitimin e pronësisë me parashkrim fitues

Për të fituar pronësinë parashkrimi fitues me titull, me duhet të plotësohen këto kushte: a) Qenia apo ekzistenca e një sendi të aftë për t'u fituar me parashkrim fitues; b) Të ekzistojë një veprim juridik i lidhur midis subjekteve, domethënë, të ekzistojë titulli; c) Të ekzistojë posedimi i sendit; d) Të kalojë koha e përcaktuar në ligj, kalimi i afatit prej 10 vjetësh për posedimin në mirëbesim³⁵.

Në ligj është parashikuar si mënyrë e fitimit të pronësisë edhe parashkrimi pa titull. Për fitimin e pronësisë sipas kësaj mënyrë të fitimit të pronësisë, duhet të plotësohen këto kushte: a) Sendi duhet të jetë i paluajtshëm; b) Posedimi i sendit; c) Sjellja e poseduesit si pronar; d) Të kalojë koha e përcaktuar në ligj, e cila në këtë rast është njëzet vjet dhe të jetë poseduar qetësisht dhe pandërprerje³⁶

Dallimi kryesor midis tyre qëndron në faktin se tek parashkrimi fitues me titull, ke ekzistencën e një titulli ose thënë ndryshe të një veprimi juridik të caktuar i cili ka për qëllim kalimin e pronësisë, ndërsa tek parashkrimi fitues pa titull, nuk ekziston titull për kalimin e pronësisë.

³² pika 33 e Vendimit nr.00-2017 (205), datë 04.04.2017 të Kolegjit Civil të Gjykatës të Lartë

³³ Po aty,

³⁴ Ardian Nuni, E Drejta Civile I, Fq. 353

³⁵ Neni 168 kodi civil

³⁶ Neni 169 kodit civil

Elementi i përbashkët i parashkrimit fitues me titull dhe atij pa titull, është posedimi i qetë dhe pa ndërprerje i sendit.

Konkluzioni

Padia e rivendikimit përkufizohet si padia e pronarit joposuedes kundër poseduesit jopronar për kthimin e sendit. Që të ushtrohet kjo e drejtë duhet: që paditësi (ai që kërkon mbrojtje me anën e padisë) të jetë pronar i sendit që kërkon (rivendikon) dhe që i padituri (ai kundër të cilit drejtohet padia) të jetë posedues i paligjshëm i sendit

E drejta e pronësisë është një e drejtë e cila ekziston në cdo kohë dhe vazhdon që të ushtrohet në cdo kohë ,në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë nga pronari . Kemi dhe një element shumë rëndësishëm lidhet me natyrën e të drejtës së pronësisë si një e drejtë reale dhe absolute. Kjo e drejtë detyron që personat e tretëve që kurdoherë dhe në cdo kohë të respektojnë të drejtën e pronësisë së pronarit mbi sendin.

comprehensive process, under the supervision of the head of the institution and the self-assessment team. Bouchamma (2007) favors the combination of actors, each of whom can contribute in their own way to the process. Once the data is collected they should be analyzed in groups set up by the educational institution itself. Subject and class teams, teachers, students and parents should also be involved in this process. Inclusion is of particular importance, the reason being that everyone should feel part of the appreciation. This involvement encourages and encourages all actors to reflect and analyze their activities, in this case teachers are the ones who are evaluated and are expected to implement the recommendations much more easily. The number of actors participating in the self-assessment and their selection is of great importance (Liu and Teddlie, 2007; Quinton, 2007), further emphasizing that it is of multiple importance, to ensure the validity of the results.

6. Conclusion

School principals should plan the MV of teachers' work at the beginning of the school year, compile the calendar of monitoring and evaluation of teachers' work; define the purpose and objectives as well as the instruments for evaluating the performance of teachers,

At school level to appoint SC coordinators in schools and leaders of professional assets for evaluation of school performance;

Practice school self-evaluation using methodologies, standards and instruments practiced by external evaluators, identifying strengths and weaknesses, in order to improve the quality of school work. Involve teachers, students, parents and the community in the self-assessment process.

To form a team of teachers at school level to evaluate the performance of teachers, where they will be part of the observation in the lessons together with the school principal.

Monitoring and evaluation of teachers' work should be done at least twice during a school year, the first evaluation should be formative evaluation, while the second evaluation should be summative. If necessary, other MVs are organized within the school year.

School principals during the MV process of teacher work, priority should be given to new teachers with whom they should have an advisory and guiding attitude, in order to give them courage for work.

Before and after the observation in the lessons, a conversation should be organized with the teacher where a warm atmosphere should prevail, open and professional communication and no space should be left for perception for non-objective evaluation.

Increase the level of cooperation between the school principal and teachers during the evaluation process, so that neither party sees evaluation as a punishment mechanism, but as one as a mechanism for teacher development in raising the quality of teaching and ensuring quality of educational institutions.

After the monitoring and evaluation process, teachers should receive feedback which is necessary to help them, to improve teaching, so it is important not only to receive feedback, but it should be substantial and objective.

Develop policies at school level for continuous professional development, based on the needs and requirements of teachers, especially in those areas which are necessary and affect the increase of quality in teaching

LITERATURA

1. TALIS(2009) and teacher education for Diversity, Educating Teachers for Diversity:Meeting the Challenges, OECD.
2. Instruments for quality assurance in EDC at school (2005), United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization.
3. Internal inspection and evaluation of the school (2011), DAR/ZA (Guide for full inspection of DAR / ZA), IKAP, Tirana.
4. Fiset, S., Héon, D., Lewis, M.&Nadeau, S. (2009), Les conditions de succès de l'implantation de l'évaluation formative des enseignements.

5. Lusthaus, Charls, Marie-Helene Adrien, Gary Anderson, and Fred Carden, *Improving the performance of the organization*, DEA, Prishtina, 2005.
6. Hyseni, H., Mita, N., Salihaj, J. & Pupovci, D. (2003). *Governance and leadership in education*. Prishtina: KEC.
7. Liu, S. et Teddlie, C. (2007). A Follow-up on Teacher Evaluation in China: Historical Analysis and Latest Trends, *Journal of Personnel Evaluation in Education*, vol. 18, no 4, pp. 253- 272.
8. Bouchamma, B., Godin, M., Jeankins Godin C. (2008). *A guide to teacher evaluation: Structured observations for all evaluators*. Maryland : Rowman & Littlefield Publishers, Inc., 133 p

NDIKIMI I TIPAREVE TË PERSONALITETIT NË PERFORMANCËN E PUNËS

Prof. Ass. Dr. Fari Bushi

Universiteti i Shkencave të Aplikuara –Ferizaj

Abstrakt

Sjellja në punë e një individi është funksion i karakteristikave individuale dhe të mjedisit dhe efekteve të kombinuara të tyre. Që sjellja në punë të jetë pozitive, duhet që cdo variabël të jetë pozitive, duke filluar nga aftësitë dhe mjeshtritë, dituritë, motivi, perceptimi, qëndrimet etj. Këto variabla duhet të ndërveprojnë me njëra-tjetrën në mënyrë që të ndikojnë në vendimet që do të marrë një individ për të punuar ose jo, për të vazhduar punën me rregull, apo për të munguar, për të ndenjur në organizatë, apo për të kërkuar një punë tjetër, për të vlerësuar pozitivisht apo negativisht punën e vet, për të respektuar eprorin, kolegët etj. Duke kuptuar sjelljen individuale në punë si një lidhshmëri në mes aspektit psikik me veprimtarinë praktike dhe ligjshmërinë e raportit njeri-punë, studiuësit vënë në pahë rëndësinë e këtij raporti në mënyrë që të mundësojë shfrytëzimin racional të të gjithë faktorëve të cilët pamëdyshje ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e punës, në kënaqësinë dhe në personalitetin e punëtorit dhe njëkohësisht në eliminimin e faktorëve negativ në zhvillimin e organizatës.

Fjalët Kyqe: *Aftësi, shkathhtësi, menaxhim, motivim, mësim, zhvillim, dituri, perceptim, informacion, personalitet, qëndrim, nevojë, përkushtim*

Hyrje

Sot bota e punës dhe e ndërmarrjeve ka ndryshuar shumë. Ajo është bërë komplekse dhe e pasur me aspekte kritike, për të cilat psikologjia mund të ofrojë metoda, mjete, dhe kompetenca duke shpreh nevojën për të përmirësuar organizimin në punë dhe mirëqenien e punonjësve. Sjellja organizative u ndihmon menaxherëve që të kuptojnë kompleksitetin e brendshëm të ndërmarrjes duke i studiuar sjelljet e njerëzve në vend të punës dhe duke i zbërthyer detyrat e përgjegjësitë të cilat janë të lidhura me vendin e punës.

Duke e kuptuar se hulumtimi i sjelljes së njerëzve në punë është bërë një nevojë e studimeve të rëndësishme, liderët e ndërmarrjeve, përkatësisht menaxherët duhet të kenë njohuri lidhur me sjelljen e njerëzve dhe të ndërmarrjeve për shkak të konkurrencës gjithnjë e më të madhe, konsumatorëve etj, në mënyrë që aktivitetet e veta t'i orientojnë kah ndryshimet që ndodhin. Të gjitha organizatat janë të përbëra nga struktura organizative të cilat në kuadër të tyre kanë anëtarët e tyre individual. Ashtu sikurse tekologjia dhe asetet që kanë nevojë për mirëmbajtje dhe menaxhim, edhe individët kanë nevojë për motivim, zhvillim dhe mirëkuptim, dhe në rastet kur nevojat e individit dhe kërkesat e organizatës janë në papajtueshmëri, kjo mund të rezultojë në frustrim dhe konflikt, e që më vonë mund të ketë konsekuenca të paparishikueshme për organizatën. Ndaj jo rastësisht sot menaxhmenti duhet të jetë i kujdesshëm që integrimi i njerëzve në organizatë të bëhet në mënyrë të planifikuar dhe për t'u kuptuar ky kujdes, duhet që punonjësit në organizatë përpos angazhimeve të veta duhet të gëzojnë edhe mundësinë e arritjes së qëllimeve të tyre individuale në mënyrë që organizata të arrijë suksesin e vet në funksionalizimin më të mirë të mundshëm. Sjellja individuale është çëhtje komplekse që preokupon shumë organizata, ndaj menaxherët kanë një përgjegjësi në përzgjedhjen e individëve të duhur e të vlefshëm për organizatën dhe zhvillimin e saj.

Vetitë e njeriut të cilat ndikojnë në punë

Puna është një çështje shumë e rëndësishme në jetë. Suksesi i saj varet nga vetitë që i posedon njeriu. Në kohën kur organizatat po ballafaqohen me mjedisin gjithnjë e më të madh konkurrues, faktori njeri është bërë shumë domethënës. Ndaj jo rastësisht firmat sot burimet njerëzore i konsiderojnë të

një rëndësie të veçantë duke aplikuar strategji të ndryshme për të arritur objektivat e tyre në aspektin e resurseve humane. Menaxhimi i burimeve njerëzore është përdorimi efikas i njerëzve, me qëllim të realizimit të objektivave që ka shtruar menaxhmenti i ndërmarrjes.¹ Numri i madh i problemeve me të cilat merret psikologjia e punës është shumë e ndërlikuar dhe komplekse, por ne në këtë punim do të mundohemi t'i apostrofojmë vetëm disa nga vetitë me të rëndësishme psiqike të njeriut të cilat ndikojnë në suksesin e punës, përkatësisht në performancën e saj, e ato janë : aftësitë, dituritë dhe shkathtësitë, motivi për punë, qëndrimet.

Aftësitë

Njerëzit dallojnë mes veti qoftë nga vetitë e tyre fizike, pra përmes pamjes së jashtme apo konstruktit të tij fizik, qoftë nga vetitë psiqike, përkatësisht mendore. Duke u nisur nga sentenca latine “Sa koka, aq mendime” mund të konstatojmë se vërtet njerëzit janë të ndryshëm dhe kjo mund të konstatohet me faktin se njerëzit e ndryshëm të llojit dhe të shkallës së njëjtë profesionale në të njëjtat kushte objektive dhe njësor të motivuar në punë arrijnë suksese të ndryshme, përkatësisht rezultate të ndryshme në punë, gjë që bie për të kuptuar se nga aftësitë e njeriut varet edhe ndryshimi në kryerjen me sukses të punëve të caktuara. Nga studimet e ndryshme është ardhë në përfundim se këto dallime parasegjithash vijnë nga këta faktorë: trashëgimia, rrethi dhe aktiviteti. Sa dhe në çfarë drejtimi vërtet do të zhvillohen mundësitë trashëguese, në një masë të madhe varet nga kushtet materiale dhe shoqërore të jetës dhe të aktivitetit të njeriut. Kushtet materiale dhe shoqërore të jetës dhe të aktivitetit të njeriut mund t'i kontribuojnë mjaft ndërrimit dhe zhvillimit të dispozicionit trashëgues. Aftësitë janë produkt i faktorëve biologjikë dhe fiziologjikë si dhe i procesit të të mësuarit, gjithashtu janë produkt i faktorëve të mjedisit dhe është vështirë që të ndryshohen. Faktorët gjenetikë caktojnë disa kufijë në aftësitë e individit, por megjithatë këta kufijë thyhen deri në një masë nga të mesuarit.² Në këtë kuptim bie fjala nëse një person ka mundësi trashëguese që të bëhet shkencëtar i mire,

¹ Ymer Havolli “ Menaxhmenti i Burimeve Njerëzore” Prishtinë, 2014, fq.11

² Prof. ass.dr. Mimoza Kasimati; Prof.ass.dr,Mimoza Manxhari “Sjellje Organizative” Tiranë 2005, fq.139.

muzicent apo dic tjetër, këtë kurrë nuk do ta arrijë, nëse nuk përgatitet, shkollohet dhe nuk merret me njohuri adekuate për atë punë.

Aftësitë Intelektuale: Nga shume autorë aftësia konsiderohet si veçori specifike e njeriut- individit që t'i vlerësojë gjërat objektivisht, të ketë reagim të shpejtë dhe të qëlluar, të ketë ndjenjë për zgjidhje të problemeve të cilat rezultojnë me efekte pozitive.³

Aftësitë Intelektuale - janë ato aftësi që nevojiten për të kryer aktivitete mendore. Aftësia intelektuale është aftësia për të realizuar dhe interpretuar informacionin, për të vlerësuar kontekstin dhe vlefshmërinë e tij. Në grupin e aftësisve intelektuale radhiten:

Aftësitë e komunikimit: janë aftësitë që përdoren kur jep dhe merrë lloje të ndryshme informacioni. Këtu përfshijnë komunikimin e ideve, ndjenjave, ose asaj që po ndodhë rreth jush. Aftësitë e komunikimit përfshijnë të dëgjuarit, të folurit, vëzhgimin dhe ndjeshmërinë, Të kesh aftësi të forta komunikimi është e rëndësishme për çdo organizatë, në çdo nivele karriere.

Aftësitë numerike: paraqesin aftësitë e njeriut në aspektin e kryerjes së operacioneve matematikore, përkatësisht aftësitë për të kryer shpejt dhe sakt operacionet matematikore, statistikore dhe përlllogaritëse.

Aftësitë e përceptimit: bazohen në krahasimin midis elementeve të ndryshme, gjegjësisht për të identifikuar ngashmëritë dhe dallimet në kryerjen e aktiviteteteve që kërkojnë përceptim vizual.

Aftësitë hapësinore: janë aftësi për t'u orientuar në hapësirë dhe kohë. Njerëzit me aftësi hapësinore pasqyrojnë gjendjen e mëhershme se si ka qenë para shumë vitesh, por mund të imagjinojnë edhe ndryshimet për të ardhmen.

Aftësitë e të mbajturit mend: paraqesin aftësinë e të mbajturit mend porositë, numrat, togëfjalshat, premtimet etj. që janë shumë të rëndësishme në punën organizative.

Aftësitë e arsyetimit indikativ: - janë aftësi për të gjetur rregulla, përkatësisht aftësi për të arritur në konkluzione të përgjithshme nisur nga elementet e veçanta.

³ Ymer Havolli "Vepër e cituar" Prishtinë, 2014, fq.56

Aftësia e të kuptuarit të fjalëve: është aftësi e njerëzve për të mësuar gjuhë të huaja, dhe për t'i folur ato.

Dituritë dhe Shkathtësitë

Dituritë paraqesin përmbajtjen e informacionit të nevojshëm për të performuar në mënyrë adekuate në punë në një nivel të pranueshëm, zakonisht i fituar nëpërmjet arsimimit formal dhe përvojës në punë.

Dija është fuqi. Kjo fjalë e urtë e vjetër është e vërtetë sot, edhe pse filozofii Francis Bacon e tha në fillim të shekullit shtatëmbëdhjetë. Kur dija e mundësuar nga kjo qasje e paprecedentë në informacion - ishte e kontrollueshme, ata që e kontrollonin atë fituan fuqi dhe u ben liderë. Tani që informacioni është praktikisht i pakontrollueshëm, fuqia është zhvendosur tek ata që e ndajnë atë.⁴

Deri në fund të këtij shekulli, parashikohet që një e treta e fuqisë punëtore në Amerikë të jetë “punëtorë të mendjes” gjë që do të thotë se rendimenti i tyre në punë matet nga vlera që ata i shtojnë informacionit.⁵ Në këtë kontekst çdo punë profesionale kërkon një sasi njohurish dhe shkathtësish, që ata fitohen siç u cek me lartë, qoftë duke mësuar apo nga përvoja. Çdo punë profesionale kërkon dituri dhe shkathtësi, ndaj çdo organizatë është gjithnjë e më shumë në përpjekje e sipër që ta ngrisin këtë fushë në të mirë të rritjes së efekteve dhe shërbimeve që ata i ofrojnë.

Dituria është shfrytëzim i plotë i informatave dhe të dhënave të pajisura me aftësi, kompetenca, ide etj. Në ekonominë e sotme dituria është baza për ngritjen dhe suksesin e organizatës, ndaj nuk është e rastit kur thuhet se meritë më e madhe për përfitimin e ndërmarrjeve është kapitali intelektual, që është një sinonim i dijes. Rëndësia e aftësive intelektuale shihet në fuqinë e tyre, të cilën e posedojnë këto resurse, dhe e cila ka të bëjë me rritjen e vlerës së ndërmarrjes. Me qëllim të shfrytëzimit të kësaj përparësie, përkatësisht me materializimin e saj, nevojitet një strategji përkatëse e cila do t'i transformojë aftësitë individuale në vlerë.⁶

⁴ Dov Seidman” How Why How We Do Anything Means Everything... in Business (and in Life) Published by John Wiley & Sons, Inc Hoboken, New Jersey, 2007 , fq 131.

⁵ Daniel Goleman” Inteligjenca Emocionale” Prishtinë, 2018, fq.194.

⁶ Gadaf Rexhepi “ Menaxhmenti Strategjik” Shkup, 2016, fq.59.

Fuqia e dijes varet nga arsimimi i mirëfilltë që është edhe faktori kryesor për dijen dhe shkathtësitë, ndaj menaxhimi sistematik i dijes bëhet me qëllim të krijimit të vlerës dhe plotësimit të nevojave strategjike e programore të secilës organizatë apo institucioni.

Duke e pasur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI.⁷

Çdo punë profesionale kërkon njohuri dhe shkathtësi dhe siç e kemi shprehur, ato fitohen gjatë jetës duke mësuar. Ndër format komplekse të të mesuarit kemi:

Të mësuarit e punëve motorike, të mësuarit verbal, dhe mësimi në formë të zgjidhjes së problemeve.

Mësimi i punëve motorike- perfshin përmirësimin e saktësisë së lëvizjeve të thjeshta dhe komplekse gjersa mjedisi ndryshon, apo thënë më thjeshtë mësimi i punëve motorike ose shkathtësive motorike përbën mësimin e lëvizjeve të nevojshme për kryerjen e ndonjë detyre. Kjo formë e mësimit karakterizohet nga puna stërvitore dhe përsëritëse, pra nga shkathtësitë që duhet mësuar p.sh. mësimi për ngasjen e veturës, ose punët që bëhen me anë të ushtrimeve që vështirë harrohen, si bie fjala ngasja e biçikletës, ose mësimi i ndonjë zeje, etj.

Mësimi verbal: shoqërohet me memorizimin dhe mbajtjen mend të fjalëve, në mënyrë që të përshkruhen elementet bazë të të mësuarit shoqëruar. Të mësuarit verbal, të shpeshtën mund të përfshijë edhe më shumë se memorizimin e fjalëve si stimuj, fotografi, vendndodhje etj. Mësimi verbal është forma më e shpeshtë shkollore e mësimit dhe materiale tjera të shkruara, por dijet e fituara në mënyrë verbale mund të harrohen shpejt, nëse nuk përsëriten shpesh.

Mësimi në formë të zgjidhjes së problemeve: Në zgjidhjen e problemeve që është një formë më e ndërlikuar e mësimit, zgjidhësi i problemit, kërkon një metodë për transformimin e problemit nga gjendja e tij aktuale në një gjendje të dëshiruar. Dijet dhe shkathtësitë fitohen nëpërmes të zgjidhjes praktike të ndonjë situatë ose problemi të rikrijuar, pra nga përvoja,

⁷ Korniza Kurrikulare e Arsimi Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë, , fq.20.

por përvoja sado që është e rëndësishme gjatë vendosjes, ajo e humb vlerën në situatat e panjohura, ndaj në zgjidhjen e problemeve duhet të bashkohet përvoja dhe intelekti. Në zgjidhjen e problemeve duhet të kihet parasysh dy gjëra: paraqitja e problemit dhe të vërejturit e problemit. Do të ishte ideale sikur të përputheshin koha e paraqitjes dhe ajo e të vërejturit të problemit. Mirëpo sipas rregullit në praktikë nuk ndodhë ashtu. Në varshmëri nga dallimi kohor ndërmjet paraqitjes dhe të vërejturit të problemit të cilin duhet zgjedhur, vendosja do të jetë e lehtë ose e vështirë.⁸

Në përgjithësi, zgjidhja e problemeve i referohet aftësisë së një personi për të menaxhuar me sukses situata komplekse dhe të papritura. Njerëzit me aftësi të mëdha për zgjidhjen e problemeve kanë një kombinim të të menduarit analitik dhe krijues, ku si rezultat ata identifikojnë shpejt problemet kur lindin, gjë që mund të identifikojnë edhe zgjidhjet me efektive. Në këtë kontekst organizatat janë gjithnjë e më shumë në kërkim të këtyre punonjësve, pasi të vërejturit e problemit në momentin e paraqitjes së tij, kryesisht varet nga dituria, aftësia dhe shkathhtësia dhe nga përvoja e marrësit të vendimit.

Motivi për punë

Motivimi është proces që nisë, drejton dhe ruan sjellje të orientuara drejt qëllimit. Termi “motivim” përdoret shpesh për të përshkruar pse një person bën diçka. Motivimi i punonjësve ka të bëjë me atë se sa i angazhuar ndihet një punonjës në të njëjtën kohë me qëllimet e organizatës dhe sa i fuqizuar ndihet ai. Motivacionet e punëtorëve, plotësimi i të cilave ndikon në moralin punues dhe në itegrimin e punëtorëve në kolektiv, dhe nëpërmes të asaj edhe në suksesin afarist të organizatës së punës së bashkuar, mund të jenë të shumëllojshme dhe të ndryshojnë prej njërit në tjetrin individ.⁹

Në kuptimin shkencor, motivimi shpjegohet si një impuls për veprim, pra motivimi mund të përshkruhet si një proces psiko-fiziologjik që nxitë një person në një aktivitet të caktuar me ndihmën e faktorëve të jashtëm dhe intra-personal. Motivimi si fenomen paraqet sigurimin dhe orientimin e sjelljeve të

⁸ Prof. Dr. Ibrahim Kuka “Vendosja Afariste”, Prishtinë, 1997, fq.57.

⁹ Dr. Zhivko K. Kostiq “Bazat e Organizimit të Organizatave të Punes së Bashkuar” Prishtinë, 1984, fq.129.

njerëzve në mënyrën e dëshiruar, ashtu që të arrihen njëkohësisht qëllimet e organizatës dhe të plotësohen nevojat vetiake të individit.¹⁰

Në përgjithësi ekzistojnë shumë teori mbi motivimin që janë plotësuese të njëra-tjetrës, ku përmes këtyre teorive studiuesit janë përpjekur të zbulojnë arsyet pse disa njerëz duan të punojnë, dhe pse disa të tjerë nuk e duan punën, dhe nga kjo rezulton se motivi varet nga individit, nga situata ose nga njerëzit me të cilët punohet.

Synimi në prezantimin e këtyre teorive të ndryshme të motivimit njerëzor, nuk është të identifikohet se cila është më e larta, por të zhvillohet një proces mendimi që do ta qojë menaxherin të zhvillojë konceptin e tij të motivimit.¹¹

Dy janë llojet e motivimit: Motivimi i brendshëm dhe ai i jashtëm.

Motivimi i brendshëm: do të thotë që motivimi për të përmbushur qëllimin vjen nga brenda, me fjalë tjera, motivimi për t'u angazhuar në një sjellje lind nga brenda individit, sepse natyrisht është kënaqësi për të, dhe jo nga një dëshirë për të fituar një lloj shpërblimi të jashtëm, psh. të luajmë një lojë, të shkruajmë një vepër, të lexojmë një libër etj. dhe të gjitha këto bëhen sepse na pëlqen, përkatësisht na bëjnë të lumtur.

Motivimi i jashtëm: i referohet sjelljes që nxitet nga shpërblime të jashtme si para, famë, nota, trofe, çmime, mirënjohje etj. Motivatorët e jashtëm zbatohen më së miri në situatat ku njerëzit kanë pak interes fillestar në kryerjen e aktivitetit, ose në rastet kur mungojnë aftësitë themelore, por këto shpërblime duhet të mbahen të vogla dhe duhet të lidhen drejtpërdrejt me kryerjen e një sjellje specifike, dhe sapo të krijohet një interes i brendshëm dhe aftësi thelbësore, motivatorët e jashtëm duhet të hiqen gradualisht. Motivimet e jashtme mund të jenë **të prekshme** si paratë, ose trofetë, ku punëtorët anagzhohen në aktivitete ku mund të gjejnë shumë të kënaqshme për të fituar një pagë, apo sportistët angazhohen në sesione stërvitore në mënyrë që të fitojnë trofe ose çmime, dhe **shpërblimet psikologjike** që mund të përfshijnë lëvdata e mirënjohje publike, psh. një solist mund të këndojë që merr vëmendjen dhe brohoritje, nga audienca e tij. Të gjitha motivimet sipas

¹⁰ Prof. Dr. Berim Ramosaj "Bazat e Menaxhimit", Prishtine, 2000, fq.218

¹¹ Бобек Шуклев „Менаџмент“ Скопје, 1998, стр 259.

prejardhjes së tyre mund t'i ndajmë në biologjike (të lindura) dhe sociale (te përvetësuara).

Motivimet biologjike (të lindura)-këto motivime i trashëgojmë, përkatësisht me to lindim. Këtu bien nevojat kryesore nga plotësimi i të cilave varet ekzistenca e njeriut dhe përfshijnë: urinë, etjen, nevojën për ajër, për strehë, për marrëdhënie seksuale dhe nevoja tjera fiziologjike të trupit. Për aq kohë sa punonjësit janë nën nxitjen e nevojave fiziologjike, interesat dhe preokupimet e tyre nuk janë te përqëndruara tek puna që bëjnë. Mund të pranojnë çfarëdo lloj pune që t'u japësh, mjaft që t'u plotësojë këto nevoja.¹²

Motivet sociale: janë motive të përvetësuara që fitohen gjatë jetës dhe ato mund të ndërrohen. Disa krejtësisht humbin, kurse të rejat krijohen, varësisht nga kushtet e jetës dhe nga përvoja personale. Në mesin e motiveve sociale do të veçonim:

Nevojat për siguri

Nevojat për t'u shoqëruar

Nevojat për t'u vlerësuar

Nevojat për t'u vetëaktualizuar

Nevojat për siguri: Njeriu si qenie njerëzore ndjen nevojën për të qenë i sigurtë në një rrethinë të sigurtë. Gjetja e një pune të mirë, një jetë stabile, pa dhimbje, pa kërcënime, me një kujdes shëndetësor, janë nevoja që përfshihen në këtë kategori.

Nevojat për t'u shoqëruar: Njeriu është qenie shoqërore dhe në mënyrë të dukshme shprehet nevoja për t'u shoqëruar me të tjerët, për t'u rrethuar nga persona të dashur. Për të shmangur problemet si vetmia, depresioni, ankthi, është e rëndësishme që njerëzit të ndihen të dashur dhe të pranuar nga të tjerët. Marrëdhëniet personale me shokët, miqtë, familjen, luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e njeriut. Kështu edhe në ambientet punuese, aty ku ekziston krijimi i një klime pranimit, përkatësisht mbështetjeje nga kolegët, shfaqet një motiv pune ku punonjësit japin kontributin e tyre më të madh.

¹² Prof. ass. dr. Mimoza Kasimati, Prof. ass. dr. Mimoza Manxhari " Veper e cituar" Tirane 2005. Fq.156.

Nevojat për t'u vlerësuar: Secili njeri synon afirmimin e tij personal, që do të thotë të çmohet, përkatësisht të vlerësohet, në rrethin social për atë që është, të ketë reputacion, të përceptohet si i rëndësishëm, dhe i aftë, si dhe të jetë i dashur dhe i popullarizuar.

Nevoja për t'u vetëaktualizuar: këto nevoja kanë të bëjnë me ngritjen në nivel më të lartë, të cilin e pretendon individi për vetveten.¹³ Meqë nevojat për t'u vatëaktualizuar pasqyrojnë materializimin, shprehjen e asaj për të cilën njeriu është i aftë, ndërmarrja mund të ofrojë mundësinë e zhvillimit të aftësive të individit. Në këtë kontekst individi është i motivuar të shprehë kreativitetin, përkatësisht aftësitë e tij, që mund të shprehen në rezultate të mira si dëshmi e atyre aftësive.

Qëndrimet

Qëndrimet paraqesin një organizim relativisht të qendrueshëm të besimeve, ndjenjave dhe prirjeve të sjelljes ndaj njerëzve, dukurive, objekteve apo gjërave të rëndësishme shoqërore. Ato janë orientim social, një prirje për t'iu përgjigjur diçkaje në mënyrë pozitive apo negative. Qëndrimet përcaktojnë përmbajtjen dhe mënyrën e reagimit të njeriut ndaj personave, dukurive dhe situatave. Kjo përmbajtje dhe mënyrë e reagimit të njeriut është e formuar në mbështetje të përvojës së tij.¹⁴

Shumë njerëz e mbështesin mendimin se qëndrimet arrihen nëpërmes përvojës, me një fjalë mësohen, por ka edhe të atillë që mendojnë se qëndrimet edhe fitohen nga faktorë gjenetik. Marrë në përgjithësi duhet të kuptojmë se qëndrimet i fitojmë gjatë jetës duke i përvetësuar idetë dhe normat sociale të rrethit në të cilin jetojmë dhe në bazë të përvojës personale.

Në bazë të vlerësimit të përvojës jetësore, ne e vlerësojmë dicka të vlefshme, ose të kundërtën, por vlerat të cilat kanë qenë negative, mund të bëhen pozitive dhe anasjelltas, varësisht nga ndryshimi në përvojë. Vlerat dhe qëndrimet janë në harmoni, por jo në çdo rast dhe këto mospërputhje shkaktohen nga shfaqja e pasojave të veprimit, pastaj sa e prekin moralisht dhe materialisht individin, sa prekin njerëz të tjerë afër ose larg individit, etj.

Gjithashtu edhe shpërblimet ndikojnë në shkallën në të cilën individët janë të motivuar për të reduktuar mospërputhjen. Shpërblimi ndikon për të reduktuar mospërputhjen duke rritur anën e qëndrueshme në balancën

¹³ Ymer Havolli "Vepër e cituar" Prishtine, 2014, fq.219.

¹⁴ Prof. Dr. Pajazit Nushi "Psikologjia" Prishtinë, 1999, fq.227.

individuale. Përderisa njerëzve në organizatë u jepen shpërblime për shërbimet që kryejnë, ata janë të prirur të tolerojnë më shumë mospërputhje në punë se sa jashtë punës.¹⁵

Qëndrimet janë të vështira për t'u studiuar, ndaj matja e tyre është çështje që meriton studime të veçanta. Njëri ndër këndvështrimet është që t'i pyesësh njerëzit thjesht se çfarë qëndrimesh kanë dhe këtë mund ta bësh duke i intervistuar, ose duke i anketuar ata. Pavarësisht se sa të dobishme janë intervistat dhe anketat duhet të kuptojmë se nuk mund të jemi gjithmonë të sigurtë se njerëzit e tregojnë te vërtetën. Qëndrimet nuk janë njohuri të thjeshta, për diç, por gjithmonë paraqesin një shkallë të caktuar të angazhimit tonë për diç, ose kundër dickahit. Ky angazhim mund të shprehet në mënyrë deklarative në shprehje të mendimit, të gjykimit për diç, ose nëpërmes të aksionit, veprimit. Mirëpo qëndrimi i deklaruar gjithmonë edhe nuk është qëndrim real. Shprehja e qëndrimeve nëpërmes dëfrimit është shumë më i besueshëm për vërtetimin e ekzistimit të qëndrimit të caktuar.¹⁶

Procesi i ndryshimit të qëndrimeve: Në ndërveprimet grupore, por edhe në raportet ndërpersonale individët përpiqen vazhdimisht të ndryshojnë sjelljen e tyre nëpërmjet ndryshimit të qëndrimit. Qëndrimet e punonjësve mund të ndryshohen dhe në disa raste është në interes të menaxhimit që ta bëjnë këtë. Bindja është ajo sipas të cilit një mesazh shkakton ndryshim në besimet, qëndrimet ose sjelljet tona. Drejtuesit mund të mos i pëlqejë qëndrimi i karakterizuar i një punonjësi që atij i duket qëndrim negativ, por ky i fundit mund të ndihet krejtësisht në rregull dhe vazhdon të sillet me atë qëndrim, ndaj detyra e drejtuesit është që të sqarohen për të ndryshuar atë qëndrim negativ te punonjësit.

Në këtë pikëpamje janë disa mënyra për t'i kapërcyer këto barriera:

E para-ndryshimi i qëndrimeve nga informacioni, pra kur marrim një informacion të saktë për diçka që nuk kemi pasur njohuri.

E dyta-mund të përdoret ndikimi i kolegëve/ shokëve e bashkëpunëtorëve për të bindur individin, posaqërisht ata që kanë ndikim tek ai punëtor.

E treta- është përfshirja e individëve me qëndrime negative në grupe pune që përpiqen në rregullimin e gjendjes.

¹⁵ Prof.ass, dr. Mimoza Kasimati, Prof.ass dr. Mimoza Manxhari " Vepër e cituar" Tiranë, 2005, fq.43.

¹⁶ Grup autorësh" Organizimi i Punes" Prishtinë, 1984. fq.67 .

E katërta-është kur drejtuesi e afron, e lavdëron, i jep mirënjohje, duke e bërë që individi të ndryshon qëndrimet negative të sjelljes së tij.

Qëndrimet në punë: Kur flasim për qëndrimet e një punonjësi në punë duhet cekur mënyrën e qëndrueshme në çdo aspekt të punës së tij duke filluar nga përkushtimi ndaj organizatës dhe mënyra se si i trajton bashkëpunëtorët, mbajtja e punonjësve, dhe kënaqësia në punë.

Përkushtimi ndaj organizatës-është një tregues i besnikërisë dhe përkushtimit ndaj organizatës. Punonjësi me qëndrimet pozitive përkushtohet dhe e ndjen në zemër kujdesin për cilësinë. Ai vepron si një nxites për të tjerët duke i frymëzuar ata, gjersa punonjësi me qëndrime negative dobëson produktivitetin. Ata janë punëtorë që shpenzojnë energji duke u ankuar, kundërshtojnë detyra e vështira, dhe nuk kujdesen për organizatën, përhapin thashetheme etj.

Mbjajtja e punonjësve- Një ambient optimist ku punonjësit ndihen të mbështetur është vendimtar për talentin në organizatë. Punonjësit që janë të lumtur në punën e tyre ndihen të vlerësuar dhe kanë më shumë gjasa që të qëndrojnë në një organizatë se sa ata që nuk e bëjnë këtë. Dhe e kundërta kur punonjësit e shohin punën si të mundimshme, të vështirë, ose si një sistem të padrejtë trajtimi, page etj. ata nuk kanë gjasa të qëndrojnë në atë organizatë.

Kënaqësia në punë-Koncepti i kënaqësisë në punë mund të paraqitet si çështje se sa një punonjës ndjen pozitivisht ose negativisht detyrat e punës, mjedisin e punës dhe marrdhëniet me punonjësit e tjerë. Njerëzit duhet të ndjejnë se ajo që bëjnë është e rëndësishme për ta. Lloji i të dhënave që punonjësit marrin në punë luan një rol të madh në përcaktimin e kënaqësisë në punë bie fjala a e shohin ata ndikimin e punës së tyre, sa plotësohen nevojat e tyre individuale, sa me drejtësi dhe paanësi trajtohet ai si individ, a marrin lëvdata për një punë të bërë mirë etj.

Konkluzione

Duke e bërë trajtimin e kësaj teme kemi ardhur në përfundim se sjellja në organizatë është dije e zbatuar që implementon njohuritë e fituara nga individët dhe grupet punuese me qëllim që organizata të arrijë rezultate sa më pozitive. Procesi i menaxhimit imponon disa karakteristika individuale nga menaxherët si dituri, aftësi, intelegjencë, përvojë e shkathtësi në procesin menaxhmentit të ndermarrjes. Për ta bërë këtë menaxherët duhet të dijnë kohën dhe momentin që këto cilësi t'i kombojnë në mënyrë që të rrisin efikasitetin dhe sigurinë në procesin e marrjes së vendimeve. Strategjia e Burimeve Njerëzore në kuadër të transformimit të ndërmarrjes duhet të jetë e formuluar qartë dhe e harmonizuar me vizionin e përgjithshëm të oganizatës, sepse burimet njerëzore janë bartës të kreativitetit dhe aktiviteteve të ndërmarrjes. Objektivat e ndërmarrjes janë përcaktimet e suksesit që duhet arritur në një kohë të caktuar. Ndërtimi i strategjisë së burimeve njerëzore kërkon një përkushtim pasi njerëzit gjatë zhvillimit dhe punës së tyre kanë kërkesa dhe motive të ndryshme, ndaj nëse ndërmarrja heziton t'i plotësojë kërkesat e arsyeshme të tyre, atëherë rrezikon mundësitë e përzgjedhjes të kandidatëve të nevojshëm për ndërmarrjen. Kështu çdo ndërmarrje për arritjen e suksesit të saj afarist kërkon të ketë njerëz të ndryshëm me aftësi, shkathtësi, talent dhe sjellje të ndryshme. Organizatat sot kanë qasje të ndryshme në sjelljen e ndryshimit të të punësuarëve, duke i dhënë përparësi cilësisë së përzgjedhjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit më të mirë të aftësive të të punësuarëve, qëndrimet e tyre pozitive, përkushtimit më të madh ndaj ndërmarrjes dhe orientimit të tyre drejt kualitetit dhe suksesit.

Bibliografia

1. Prof. Dr. Berim Ramosaj” Bazat e Menaxhimit”, Prishtinë, 2000.
2. Бобек Шуклев „Менаџмент” Скопје, 1998.
3. Dov Seidman” How Why How We Do Anything Means Everything... in Business
(and in Life) Published by John Wiley & Sons, Inc Hoboken, New Jersey.2007.
4. Daniel Goleman” Inteligjenca Emocionale” Prishtinë, 2018
5. Gadaf Rexhepi “ Menaxhmenti Strategjik” Shkup, 2016.
6. Prof.ass, dr. Mimoza Kasimati, Prof.ass dr. Mimoza Manxhari “ Sjellje Organizative” Tiranë, 2005..
7. Grup autorësh” Organizimi i Punes” Prishtinë, 1984.
8. Edward Russel-Walling “ Menaxhimi” Tiranë, 2016.
9. Ymer Havolli” Menaxhmenti i Burimeve Njerëzore” Prishtinë, 2014.
10. Prof. Dr. Pajazit Nushi “ Psikologjia” Prishtinë, 1999.
11. Dr. Ali Jakupi “ Ekonomia dhe Organizimi i Ndermarrjes” Prishtinë, 1997
12. Prof. Dr. Ibrahim Kuka “ Vendosja Afariste”, Prishtinë, 1997.
13. Dr. Zhivko K. Kostiq “ Bazat e Organizimit të Organizatave të Punës së Bashkuar” Prishtinë, 1984.
14. Charles W. L.Hill ”Global Business Today“ Second Edition, New York, 2002.
15. Berim Ramosaj” Leadership” Pejë, 2017
16. Taki Fiti, Veland Ramadani “ Ndërmarrësia” Tetovë, 2013.
17. David Handerson” Klasikë të mendimit ekonomik” Tiranë, 2007.
18. F. Patrick Butler” Business research Sources-A referenc navigator” Boston, 1999.
19. Barritt Chuck, Alderman Jr F. Lee, Creating a Reusable Learning Objects Strategy, first edition, Pfeiffer, San Francisko, 2004.
20. Belul Beqaj” Lidërsipi” Prishtinë, 2010.
21. Peter F. Drucker, “Praksa rukovođenja” Privreda, Zagreb, 1961.
22. Departamenti i Tregtisë se SHBA-se “ Etika e Biznesit” Ribotuar nga Zyra e SHBA-së, Prishtinë. 2007.
23. Batrol, K. Martin, D. “ Menagement” McGraw-Hill, New, York, 1991
24. Knežević M, Novak M, Sikavica P. Problemi funkcioniranja I razvoja samoupravnih organizacija, Zagreb, 1985.
25. Isa Mustafa, “Lidërsip-udhëheqja” efiçienca dhe efektiviteti, Prishtinë, Riinvest, 2004.

RELATIONSHIP BETWEEN RELIGIOSITY, SELF-REGULATION AND ACADEMIC PERFORMANCE AMONG ADOLESCENTS

Dr.sc. LON LASKA

Faculty of Social Sciences and Education
Lecturer, College ``DARDANIA``, Prishtina
Email: lon.laska@hotmail.com

MA. Fikri Hajdari

Master of Arts in School Psychology and Counseling
Email: fikri.hajdari@hotmail.com

Abstract

The purpose of this paper is to identify what kind of relationship exists between religiosity, self-regulation and academic performance in adolescents, as well as to determine if there are gender differences in these variables. The research was conducted on adolescents aged 15 to 18 years with a sample of 480 respondents. Data collection was conducted online through a poll where all adolescents residing in the Republic of Kosovo could have access. The results showed a positive correlation of religiosity with academic performance and self-regulation. Gender differences in self-regulation and academic performance were also found. This study is only an initial step to further study the role of religiosity and self-regulation in academic performance and other areas regarding adolescent psychological well-being.

Keywords: *Academic performance, religiosity, self-regulation, adolescence, family size.*

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të identifikohet se çfarë ndërlidhje ekziston mes religjiozitetit, vetë-rregullimit dhe performancës akademike tek adoleshentët, po ashtu të përcaktohet nëse ekzistojnë dallime gjinore për nga

këto variabla. Hulumtimi është realizuar tek adoleshentët e moshës 15 deri në 18 vjet me një mostër prej 480 të anketuarve. Grumbullimi i të dhënave është realizuar online përmes një sondazhi ku kanë mundur të kenë qasje të gjithë adoleshentët që banojnë në republikën e Kosovës. Rezultatet treguan një ndërlidhje pozitive të religjiozitetit me performancën akademike dhe vetërregullimin. Poashtu u gjetën edhe dallime gjinore për nga vetërregullimi dhe performanca akademike. Ky studim është vetëm një hap fillestar për të studiuar edhe më tepër rolin e religjiozitetit dhe vetërregullimit në performancën akademike dhe në fushat tjera sa i përketë mirëqenies psikologjike tek adoleshentët.

Fjalët kyçe: *Performancë akademike, religjiozitet, vetërregullim, adoleshencë, madhësia e familjes.*

1. Hyrje

Religjioni është njëra ndër temat që ngjall më së shumti diskutime në shoqërin Kosovare, bazuar në këtë është e rëndësishme të studiohet religjioni dhe ndikimi i tij në jetën e shoqërisë tonë. Diskutohet edhe për religjionin si një faktor për ndikim të madh në jetën e njeriut, andaj është e rëndësishme që tashmë ti vihet një ngjyrim shkencor religjionit si fenomen. Diskutohet edhe sot se duhet apo nuk duhet të futet religjioni si lëndë shkollore nëpër institucione arsimore.

Adoleshenca si periudha me kritike cilësohet me një sërë ndryshime fizike, emocionale dhe psikologjike. Është e rëndësishme të identifikojmë se cilët faktor kontribuojn në sjelljet më të përshtatshme dhe performancën e tyre akademike. Andaj vetërregullimi si variabël studimore e këtij punimi ka po aq rëndësi sa edhe religjioni. Sot njerëzit marrin vlerësime sa më tepër që i përshtaten rregullave dhe normave sociale, andaj edhe adoleshentët me një vetërregullim të lartëdo kenë cilësi të mira të planifikimit, monitorimit, organizimit dhe reflektimit. Por si janë tëndërlidhura këto cilësi me religjionin dhe performancën akademike, është njëra ndër qëllimet kryesore të këtij punimi. Në anën tjetër ky punim gjithashtu hulumton edhe dallimet gjinore tek

adoleshentët pikërisht sa i përket religjionit, vetërregullimit dhe performancës akademike.

Rezultatet e tilla do jenë një kontribut i pakontestueshëm për shoqërinë Kosovare, ministrin e arsimit dhe të gjithë pedagogët dhe prindërit për të dëshmuar rëndësin e vetërregullimit në jetët e adoleshentëve. Madhësia e familjes në anën tjetër është një faktor i rëndësishëm për performancën akademike, këtë e dëshmojnë studimet e ndryshme të cilat do të shqyrtohen në këtëpunim.

Adoleshenca është identifikuar si një periudhë zhvillimi ku manifestohen veçanërisht nivele të larta të sjelljeve jo të shëndetshme dhe të rrezikshme (si përdorimi i substancave) (Casey, Jones, & Somerville, 2011). Prandaj, është me rëndësi të identifikohen mekanizmat që mund t'i bëjnë adoleshentët më ndërgjegjshëm ndaj sjelljes së dëmshme dhe të rrezikshme.

Ndërkohë që motivimi fetar mund të jetë një faktor përcaktues që shpjegon nëse dhe si mund të lidhen religjioni i adoleshentëve me sjelljet e tyre shëndetësore, vetë-rregullimi nuk është shqyrtuar në mënyrë sistematike si mekanizëm lidhës që ndihmon në përcaktimin nëse këto ndërlidhje janë pozitive ose negative.

Profili psikologjik i individëve fetarë është diçka si paradoks. Në të vërtetë, si arrijnë individët fetarë të qëndrojnë të qetë dhe të kënaqur ndërsa ata po përpiqen të plotësojnë standardet e larta të fesë së tyre? Psikologët kanë ofruar një varg përgjigjesh në këtë pyetje duke sugjeruar se feja mund të kënaqë motivet e vetë-përmirësimit (Sedikides & Gebauer, 2010), pranimiti i grupit (Ysseldyk, Matheson, & Anisman, 2010), bashkëngjitje (Granqvist, Mikulincer, & Shaver, 2010), dhe menaxhimi i terrorit (Vail et al., 2010).

Teorikisht, dimensionet qendrore dhe periferike të religjionit mund të kenë ndikim në suksesin arsimor të nxënësve. Ky arsyetim teorik daton nga 'baballarët themelues' të sociologjisë moderne. Për shembull, Emile Durkheim ([1897], 2006) argumentuan se rrjetet fetare mund të integrojnë anëtarët e vet dhe do të kenë pasoja të dobishme (të tilla si parandalimi i vetëvrasjes), pavarësisht nga përmbajtja e veçantë e besimeve fetare. Ai më tej pohoi se forca e integritetit shoqëror të një individi në një rrjet fetar është më e fortë kur një person është më i angazhuar në praktikën (institucionale) fetare. Një tjetër pionier i sociologjisë, Max Weber (1920, 2010), u përqendrua në ndikimin e

besimeve fetare në jetën e njerëzve pasi pohoi se protestantizmi asketik shkakton aspirata të larta, lokus të brendshëm të kontrollit dhe vlerat e punës së vështirë, të cilat janë përcaktues të qartë të suksesit në shkollë (Jones, 1997).

Arritja akademike është një parametër i rëndësishëm që përdoret në matjen e suksesit ose dështimit të studentëve në një lëndë të veçantë në shkollë. Suksesi, në një institucion arsimor matet nga performanca akademike. Performanca e nxënësve në shkollën e mesme është bërë një shqetësim i zakonshëm i prindërve, ligjvënësve, mësuesve, këshilltarëve dhe psikologëve. Sipas Bell (2002), prindërit i kushtojnë shumë resurse arsimit të fëmijëve të tyre sepse besojnë se performanca e mirë akademike do të sigurojë një të ardhme të qëndrueshme për ta. Uwaifo (2008) ia atribuon shkaktun e performancës së dobët të fëmijëve një kombinimi të faktorëve personal dhe institucional. Faktorët personalë përfshijnë nivelin e inteligjencës, dijes dhe aftësisë së individit ndërsa faktorët institucional janë ndikimi familjar ose prindëror.

Olayinka (2009) theksoi se familja është baza e shoqërisë dhe raportoi se një fëmijëri e qëndrueshme dhe e zhvilluar mirë mund të garantohet nga një familje e qëndrueshme. Statusi aktual i dobët ekonomik në pjesën më të madhe të prindërve dhe familjeve në vend ka ekspozuar fëmijët ndaj sfidave të padëshiruara që kanë ndikuar negativisht në performancën e tyre akademike në shkollë. Cilado që të jetë arsyeja për këto shfaqje të dobët duhet të përbëjë një shkak shqetësimi sepse performanca akademike e studentëve luan një rol të rëndësishëm në prodhimin e të diplomuarve me cilësi më të mirë, të cilët do të bëhen udhëheqës të mëdhenj dhe fuqi punëtore për vendin, pra përgjegjës për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Disa indikatorë të tillë si zakonet e studimit, vetë-koncepti, mjediset shkollore, strategjitë e kualifikimit dhe mësimdhënies së mësuesve, qeveria, klasa sociale e prindërve dhe statusi arsimor i prindërve, inputet e prindërve janë identifikuar si faktorë përgjegjës për performancën e dobët akademike të studentëve (Ella, Akpabio & Samson-Akpan, 2015; Aremu & Sokan, 2003).

Përveç sa u tha më sipër, llojit të familjes dhe madhësisë së familjes nuk u është dhënë vëmendjeje duhur në rajone të ndryshme të cilat mund të kontribuojnë pozitivisht ose negativisht në performancën akademike të një studenti.

2. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Ky punim ka për qëllim për të identifikuar se si religjioni dhe vetërregullimi janë të ndërlidhur me performancën akademike. Andaj edhe si objektiva kryesore të këtij punimi studimor janë:

- Të identifikohet ndërlidhja mes religjionit me vetërregullimin dhe me performancën akademike.
- Të identifikohen nëse ekzistojnë dallime gjinore për nga religjioni, vetërregullimi dhe performanca akademike.
- Të përcaktohet se çfarë ndërlidhje ekziston mes madhësis së familjes dhe performancës akademike.

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Performanca akademike është njëra ndër dukurit më të rëndësishme në ambientet shkollore. Të gjithë duan të kenë një performancë të kënaqshme. Për të arritur një performancë të mirëakademike në fakt ndikojn një sërë faktorësh, andaj për këtë arsye në këtë studim janë përcaktuar pyetje kërkimore dhe hipoteza që kontribuojn në identifikimin e faktorëve pozitiv nëperformancën akademike. Në këtë punim janë parashtruar këto pyetje kërkimore dhe hipoteza:

Pyetjet kërkimore:

Pyetje kërkimore 1: Çfarë ndërlidhje ekziston mes religjiozitetit, performancës akademike dhe vetë-rregullimit tek adoleshentët?

Pyetje kërkimore 2: A ekzistojnë dallime gjinore për nga religjioziteti, performanca akademike dhe vetë-rregullimit tek adoleshentët?

Pyetje kërkimore 3: Çfarë ndërlidhje ekziston mes praktikave publike dhe private të religjiozitetit për nga vetë-rregullimi dhe performanca akademike?

Pyetje kërkimore 4: Cili është roli i dimenzioneve të vetë-rregullimit (planifikimi, kontrollimi, monitorimi dhe reflektimi) në religjiozitetin?

Pyetje kërkimore 5: Cili është roli i dimensioneve të vetë-rregullimit (planifikimi, kontrollimi, monitorimi dhe reflektimi) në performancën akademike?

Pyetje kërkimore 6: Çfarë ndërlidhje ekziston mes numrit të anëtarëve të familjes dhe performancës akademike?

Hipotezat:

H1. Sa më religjioz që janë adoleshentët aq më të lartë e kanë performancën akademike dhe vetë-rregullimin.

H2. Adoleshentet femra janë më pak religjioze por vetë-rregullimin dhe performancën akademike e kanë më të lartë sesa meshkujt.

H3. Adoleshentët me praktika private të religjiozitetit do të kenë ndërlidhje me vetë-rregullim dhe performancë akademike më të lartë se sa adoleshentët me praktika publike.

H4. Kontrollimi si dimenzion i vetë-rregullimit do jetë më parashikuesi për religjiozitetin

H5. Planifikimi si dimenzion i vetë-rregullimit do jetë më parashikuesi për performancën akademike.

H6. Sa më i madh numri i anëtarëve të famijes aq më e ulët do jetë performanca akademike.

3. Metodologjia e hulumtimit

Sa i përket metodës në këtë studim, theksoj se është përdorur metoda kuantitative e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, me anë të pyetësorëve, si variabël të pavarur kemi religjiozitetin, kurse si variabla të varuar performance akademike dhe vetë-rregullimin. Dizajni i këtij hulumtimi është korrelacional - parashikues.

3.1. Mostra dhe mostërzimi

Mostra përbëhet nga 480 të anketuar tek adoleshentët 15 deri në 18 vjet të republikës së Kosovës. Grumbullimi i të dhënave është realizuar përmes një sondazhi online i cili është shpërndarë nëpër rrjetet dhe aplikacionet sociale si

facebook, whats app, viber dhe kudo qëadoleshentët kanë pasur qasje dhe që kanë mundur të përgjigjen në sondazhin online. Andaj si e tillë mostra është e rastësishme e thjesht

3.2. Instrumentet

Si instrument matës për Vetë-rregullimin do të përdoret; Pyetëtori Formues i vetë-rregullimit, i cili mat nivelin e aftësisë së perceptuar të individit në katër përbërësit ose dimensioneve thelbësore të vetë-rregullimit:

1. Planifikimi fillon prej itemit 1 deri në 5. Planifikimin dhe artikulumin e asaj që dëshirohet të arrihet.

2. Monitorimi fillon nga itemi 6 deri në 11. Monitorohet progresi dhe ndërhyrja në lidhje me qëllimet e individit.

3. Kontrollimi fillon nga itemi 12 deri në 17. Kontrollimi i ndryshimeve duke zbatuar strategji specifike kur gjërat nuk po shkojnë siç është planifikuar.

4. Reflektimi fillon nga itemi 18 deri në 22. Të menduarit për atë që është punuar dhe çfarë mund të bëhet më mirë herën tjetër.

Nxënësit kanë plotësuar pyetësin me iteme vetë-vlerësues në një shkallë të Likerit prej 5-pikë. Kjo shkallë varion nga 1 (Jo shumë si unë) deri në 5 (Shumë si unë). Ky instrument është i aplikueshëm për nxënësit dhe studentët.

Pyetëtori u testua për besueshmërinë duke përdorur koeficientin alfa2 të Cronbach me 5,543 nxënës të shkollave të mesme gjatë viteve shkollore 2017, 2018 dhe-2019. Pyetëtori i përgjithshëm i vetë-rregullimit u gjet të jetë mjaft i besueshëm (22 iteme; $\alpha = .896$). Nënshkalla e planit përbëhej nga 5 iteme ($\alpha = .632$), nënshkalla e monitorit përbëhej nga 6 iteme $\alpha = .704$), nënshkalla e kontrollit përbëhej nga 6 iteme ($\alpha = .744$), dhe nënshkalla reflektimi përbëhej nga 5 iteme ($\alpha = .682$). Kur u shndërrua në një shkallë 100 pikësh, kuartili i poshtëm shkonte nga 20 në 72 dhe kuartili i lartë shkonte nga 81 në 100. Pyetjet që janë inkuadruar negativisht dhe për këtë arsye shënohen të kundërt përcaktohen me "(N)".

Performanca akademike është matur matet duke vetë-deklaruar nxënësi për notën e tyre mesatare.

Madhësia e familjes është matur nga vetë-deklarimi i subjektit se me sa anëtarë të familjes banon në shtëpi.

3.3. Analiza e të dhënave

Për analizën e të dhënave së pari është testuar besueshmëria e pyetësorit me Alfa Chronbach, pastaj analiza e mëtutjeshme e të dhënave do të bëhet me anë të analizave deskriptive, korrelacionit dhe analizave të tjera joparametrike sepse të dhënat kanë shpërndaje jonormale. Gjatë përpunimit të të dhënave disa analiza statistikore e kanë reduktuar numrin e mostrës, këtë e bënë SPSS (programi për përpunime statistikore) për shkak se disa respondent nuk kanë dhënë përgjigje në pyetjet e sondazhit. Për këtë janë koduar me (-99) të gjitha përgjigjet që mungonin.

3.4. Konsiderata etike dhe procedurat

Për këtë punim janë respektuara maksimalisht hapat etik të hulumtimit shkencor. Është ruajtur dhe respektuar burimi i çdo materiali që gjendet në këtë punim po ashtu do të respektohet konsidencialiteti i identitetit të të gjithë pjesëmarrësve. Për realizimin e të dhënave së pari është formuar një sondazh në google forms, në të cilin janë vendosur pyetjet demografike së bashku me instrumentet matëse. Pyetësi online është shpërndarë nëpër rrjetet sociale dhe aplikacione telefonike dhe kompjuterike derisa është arritur një numër i konsideruar i respondentëve.

4. Rezultatet e hulumtimit

4.1. Rezultatet në bazë të hipotezave

Tabela 4. Analizat deskriptive për variablat e studimi

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Mosha	479	1.00	4.00	2.6785	.97938
Gjinia	480	1.00	2.00	1.7021	.45782
Madhësia e familjes	480	2.00	8.00	5.0000	1.56020
Performanca akademike	479	1.00	5.00	4.2380	.89731
Religjioni	451	15.00	75.00	58.3126	10.95333
Vetërregullimi	458	22.00	110.00	86.6943	13.19184
Valid N (listwise)	433				

Shënim:Në tabelë janë paraqitur statistikat deskriptive për variablat e studimit, Mosha (M=2.67:DS=0.97), Gjinia (M=1.70:DS=0.45), Madhësia e familjes (M=5.00:DS=1.56),Performanca akademike (M=4.23:DS=0.89), Religjioni (M=58.31:DS=10.95) dhe Vetërregullimi (M=86.69:DS=13.19).

H1. Sa më religjioz që janë adoleshentët aq më të lartë e kanë performancën akademike dhe vetë-rregullimin.

Tabela 5. Korrelacioni i Spirmanit për religjiozitetin,performancën akademike dhe vetërregullimi

Korrelacioni i Spirmanit				
		Religjioni	Performanca akademike	Vetërregullimi
Religjioni	Correlation Coefficient	1.000	.067	.271**
	Sig. (2-tailed)	.	.159	.000
	N	451	450	434
Performanca akademike	Correlation Coefficient	.067	1.000	.280**
Në pyetjen e tetë vihet re se numrin më të madh të përgjigjeve positive e japin nxënësit të cilët nuk kanë pasur mardhënie të ngushtë me nxënësit me nevoja të veçanta. Kjo mund të jetë pasojë e faktorëve të tillë si largësia e tyre në komunikim, distance sociale apo edhe distance gjeografike. Një tjetër factor i rëndësishëm është se për fëmijët me nevoja të veçanta besimi që ata krijojnë është më i madh tek mësuesi/ja e tyre prandaj dhe ndihmën kryesore ata e kërkojnë tek ky person para se të kërkojnë ndihmë tek shokët e tyre. Kjo gjë vihet re në tëdy ciklet e shkollave ku është zhvilluar anketimi. Në pyetjen e nëntë vihen re një gadishmëri e nxënësve për të ndihmuar shokun e tyre me nevoja të veçanta sin ë klasë dhe jashtë saj për tëdy ciklet mësimore. Kjo është një nga aspektet më positive të shkollave tona ku fëmijët e tjerësë pari e pranojnë në mjedisin e tyre një fëmijë me nevoja të veçanta dhe së dyti ata janë të prirur të kontribuojnë në një mjedis sa më miqësor ndaj tyre. Po kështu edhe në përgjigjet e pyetjes dhjetë gjendet e njëjta frymë e mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta nga fëmijët e tjerë ku ata japin sygjerime nga më të ndryshmet për përmirësimin e ambjentit të klasës në mënyrë që ata të ndihen sa më të qetë e të bëhen më të interesuar për të marrë njohuritë mësimore. Edhe pse shumic e tyre e shikon këtë përmirësim me bazën material të klasave ku ata zhvillojnë mësim jo në pak raste hidhen ide të përmirësimit të aspektit social për target grupin e fëmijëve me nevoja të veçanta.




Figura 8. Pergjigjet e nxënësve për pyetjen 8 të anketës së bërë




Figura 9. Pergjigjet e nxënësve për pyetjen 9 të anketës së bërë




Figura 10. Pergjigjet e nxënësve për pyetjen 10 të anketës së bërë

Konkluzione

Në këtë studim të realizuar në disa shkolla të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm nga zona e Tiranës dhe Krujës është synuar të sillen elementët pozitivë dhe shqetësues që ndejnë fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin tonë. Grupet e anketuara i takojnë nxënësve nga qendrat urbane, periferike dhe në zonave rurale si dhe nxënës të shkollave publike dhe jo-publike. Përzgjedhja e tyre është bërë që të ketë një përfaqësim sa më të gjerë të nxënësve si në numër edhe në llojshmërinë e tyre. Vihet re që në pjesën më të madhe të klasave ku është zhvilluar anketimi ka nxënës me nevoja të veçanta për të cilët në arsimin public në përgjithësi është angazhaur mësuesi ndihmës ndërsa në arsimin jo-publik ky element mungon pasi numri i nxënësve në klasa është më i vogël. Vihet re që në shkollat 9-vjeçare numri i nxënësve me nevoja të veçanta të jetë më i madh se në shkollat e mesme. Kjo gjë është e lidhur kryesisht me faktin se për një pjesë të mirë të këtyre fëmijëve arsimimi i tyre ndërpritet në ciklin 9-vjeçar sidomos kjo në zonat rurale. Një arsye tjetër mund të jetë dhe përbindja e përgjigjeve nga target-grupi i marrë rastësisht në anketë. Interesant është fakti se fëmijët me nevoja të veçanta i tërheq shkolla duke i bërë ata pjesëmarrës të rregullt të proceseve mësimore sin ë mësimin në klasa dhe gjatë mësimin në distancë. Vetëm në raste të caktuara vihet re një tendencë e tyre për të qënë shkak i ndërprerjes së mësimin. Pjesa më e madhe e këtyre

fëmijëve kanë ndjekur rregullisht edhe mësimin në distancë edhe pse për ta ka qënë më e vështirë qoftë për shkak të distancave edhe për shkak të prishjes së rregullsisë së përditshmërisë së tyre. Kjo gjë mund të jetë e lidhur gjithashtu edhe me mungesat e mjeteve të domosdoshme gjatë procesit mësimor on-line (telefon, tablet, kompjuter, internet, etj) por edhe me faktin se mungesa e mësuesve ndihmës e bën më të vështirë për ta kuptimin e mësimin. Edhe pse vihet re një distancë midis nxënësve normal dhe nxënësve me nevoja të veçanta për shkak të largësisë midis tyre në komunikim, distancancave sociale, distancave gjeografike apo besimit që ata ndërtojnë me shokët e tyre duhet theksuar se në të gjitha klasat dhe nxënësit vihet re një gadishmëri e nxënësve për të ndihmuar shokun e tyre me nevoja të veçanta si në klasë dhe jashtë saj për të dy ciklet mësimore. Kjo është një nga aspektet më positive të shkollave tona ku fëmijët e tjerë së pari e pranojnë në mjedisin e tyre një fëmijë me nevoja të veçanta dhe së dyti ata janë të prirur të kontribuojnë në një mjedis sa më miqësor ndaj tyre. Fryma e tyre e mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta nga fëmijët e tjerë duket qartë edhe tek sygjerimet që ata japin. Edhe pse shumica e tyre e shikon këtë përmirësim me bazën material të klasave ku ata zhvillojnë mësim jo në pak raste hidhen ide të përmirësimit të aspektit social për target grupin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Këto rezultate tregojnë një vlerë të vërtetë të arsimit tonë në lidhje me interesimin e madh të familjeve që kanë nxënës me nevoja të veçanta nga një anë dhe nga ana tjetër përgjigjja me të njëjtën monedhë qoftë nga institucionet arsimore edhe nga nxënësit e tjerë duke e bërë shumë më të lehtë procesin mësimor për këta fëmijë. Ajo që mbetet për t'u përmirësuar është baza material e shkollave tona dhe konceptimi i situatave mësimore (atje ku mundet) edhe për fëmijët e këtij target grupi.

Literarura

<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2021/02/Manuali-per-mesuesit-ndihmes.pdf>

<https://shkollaime.al/mod/book/view.php?id=6&chapterid=26>

<https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/si-te-ndihmojme-nxenesit-me-nevoja-te-vecanta>

<http://revistapsikologji.com/personat-me-nevoja-te-vecanta-dhe-ndryshimi-i-terminologjise/>

ASSESSMENT OF HYPERTENSION AND DIABETES MELLITUS IN THE VLORA CITY IN 2021

Dr. Denada Selfo

Dr. Glodiana Sinanaj

Faculty of Public Health, University of Vlora

denadaselfo@yahoo.com

Abstrakt

Presioni arterial dhe diabeti mellitus janë dy patologji të zakonshme në mbarë botën. Sëmundjet kardiovaskulare dhe ato të rritjes së sheqerit në gjak, kanë ardhur duke u shtuar në numër, duke zënë vendin e parë në shkaqet kryesore të vdekshmërisë në shumicën e vendeve të zhvilluara të botës.

Qëllimi: Vlerësimi i incidencës së HTA dhe diabetit mellitus në popullatën e Vlorës në vitin 2021.

Metodat e studimit: Nëpërmjet këtij studimi depistues u bë e mundur matja e Presionit arterial dhe glicemisë në komunitetin e qytetit të Vlorës në vitin 2021. Janë përdorur pyetësorë me pacientët mbi problemet e sëmundjeve të HTA dhe Diabetis Mellitus dhe skedat e vlerësimit lidhur me këto sëmundje.

Rezultate: Sëmundja e diabetit të sheqerit prek të dy gjinitë pothuajse njësoj. Moshë mesatare e pjesëmarrësve në vlera të larta të TA ishte 60 vjeç. Moshë mesatare e të gjithë pjesëmarrësve ishte 60 ± 5 vjeç. Nga popullata jonë gjinia femërore përbënte 59%, 51% e përbënin grup moshë 43-62 vjeç, 14 % gr.moshë 22-42 vjeç. 44% e tyre me arsim të mesëm , 27% me arsim të lartë dhe 29% me arsim të ulët. 45% e popullatës e marrë në studim e kishin kaluar COVID-19. 74% e popullatës tonë ishin duhanpirës. 66% e tyre nuk konsumojnë alkool. Në vlerat e matura të glicemisë mbi 200-417mg/dL ishin 8%.

Konkluzione: Prevalenca e presionit arterial dhe glicemisë ishte më e ulët se sa pritej në Vlorë. Preken meshkujt dhe femrat pothuaj njësoj si për

diabetin dhe tensionin e lartë të gjakut , kjo si pasojë e përdorimit të duhanit dhe alkolit.

Rekomandime: Të vlerësohet HTA në praktikën e përditshme, në burra mbi 40 vjec dhe gratë mbi 50 vjec. Sensibilizimi, depistimi dhe monitori i popullatës i rëndësishëm duke i orientuar drejt sjelljeve të shëndetshme. Lidhur me edukimin shëndetësor, sugjerojmë të hartohen metodologji të edukimit, që të jenë të përshtatshme dhe efektive për të gjitha kategoritë e pacientëve.

Fjale Kyce: *diabeti i sheqerit, T.A, ushqyerja e shëndetshme, BMI.*

Hyrje:

Presioni arterial dhe diabeti mellitus janë dy patologji të zakonshme në mbarë botën. Sëmundjet kardiovaskulare kanë ardhur duke u shtuar në numër, duke zënë vendin e parë në shkaqet kryesore të vdekshmërisë në shumicën e vendeve të zhvilluara të botës. Studime të shumta tregojnë se një dietë e kontrolluar nga yndyrnat, reduktimi i stresit, aktiviteti fizik dhe shmangia e duhan pirjes mund ta parandalojnë, eliminojnë apo pakësojnë pothuajse të gjitha format e sëmundjeve të zemrës. Obezët, konsumuesit e duhanit, personat me dietë të çekuilibruar, të pasur me yndyrna, personat që bëjnë jetë sedentare, kanë më shumë gjasa të kenë tendencë për presion të lartë të gjakut. Diabeti është një sëmundje kronike që ndodh ose kur pankreasi nuk prodhon insulinë të mjaftueshme ose kur trupi nuk mund të përdorë efektivisht insulinën që prodhon. Insulina është një hormon që rregullon sheqerin në gjak. Hiperglicemia, ose ngritja e sheqerit në gjak, është një efekt i zakonshëm i diabetit të pakontrolluar dhe me kalimin e kohës shkakton dëme serioze në shumë sisteme të trupit, veçanërisht në nervat dhe enët e gjakut. Diabeti Mellito, sipas vlerësimeve të kohëve të fundit, do të interesojë në vitin 2025, në botë më shumë se 300 milion personave, vetëm në Veneto do të jenë më shumë se 400 mijë vetë që do të vuajnë nga kjo sëmundje. Vlera e këtyre shifrave na lë të kuptojmë se diabeti është bërë një gjëndje shëndetësore kritike sepse shkakton çrregullime dhe vdjekje. Duke u nisur nga ky këndvështrim, edukimi shëndetësor i organizuar, në të cilin bën pjesë dhe ky projekt i

organizuar prej nesh, paraqet hapin e parë për parandalimin e diabetit ose kur është i pranishëm, për të parandaluar komplikimet e tij.

Të dhëna kombëtare e ndërkombëtare

Prevalenca e Diabetit në Shqipëri në popullatën adulte është 1.9%, që do të thotë se kemi afërsisht 60 mijë diabetikë të njohur. Në fakt numri duhet të jetë 2-3 herë më i lartë, pasi në disa depistime të kryera në Tiranë (2004,2006, 2008, 2009,2010) prevalenca e Diabetit të padiagnostikuar ka qënë 3-4%, që do të thotë se në realitet shifra e përafërt e diabetikëve duhet të jetë 120-150 mijë. Moshë më e prekur nga diabeti është grupmosha 40-65 vjeç që përbën gati 40% të rasteve, por diabeti tip 2 po haset gjithnjë e më shpesh edhe në moshat 30-40 vjeç. Sipas OBSH, Diabeti shkakton çdo vit 5% të vdekjeve globale dhe mendohet se vdekjet nga diabeti në 10 vitet e ardhshme do të rriten me 50%. Në çdo 10 sekonda në botë shtohen dy njerëz të tjerë me diabet dhe se çdo 10 sekonda vdes një njeri nga shkaqe që lidhen me diabetin. 80% e njerëzve me diabet jetojnë në vendet me të ardhura të pakta dhe të mesme dhe mendohet se vdekjet nga diabeti në 10 vitet e ardhshme në këto vende do të rriten me 80%. Në vendet e zhvilluara diabeti dhe numri më i madh i diabetikëve haset në mosha mbi 65 vjeç, ndërsa në vendet në zhvillim diabeti dhe numri më i madh i diabetikëve haset në moshat 45-64 vjeç, por vitet e fundit diabeti tip 2 po takohet më shpesh edhe në moshat 30-40 vjeç.

Qëllimi dhe objektiva të studimit

Vlerësimi i incidencës së HTA dhe diabetit mellitus në personat adultë të qytetit të Vlorës në periudhën 2021-2023.

Objektivat

1. Matja e presionit arterial në popullatën në qytetin e Vlorës
2. Matja e glicemisë në popullatën në qytetin e Vlorës
3. Informimi i komunitetit në lidhje me faktorët të cilët ndikojnë negativisht në rritjen e nivelit të presionit arterial dhe nivelit të glicemisë

Metodologjia e realizimit të studimit


Nëpërmjet këtij studimi depistues u bë e mundur matja e Presionit arterial dhe glicemisë në komunitetin e qytetit të Vlorës në 2021. Vështirësi ka qenë matja e këtyre parametrave në terren si pasojë e situatës së pandemisë. Kjo justifikon dhe nr e pjesëmarrësve në studim (N-500). Për t'ia arritur qëllimit të studimit u formuan 3 grupe pune të cilët realizuan matjen e këtyre dy parametrave për qytetarët të cilët dëshironin të realizonin matjen e TA dhe nivelit të glicemisë. Janë përdorur pyetësorë me pacientët mbi problemet e sëmundjeve të HTA dhe Diabetis Mellitus dhe skedat e vlerësimit lidhur me këto sëmundje. Theksoj që përvec matjeve në terren është shpërndarë dhe një pyetësorë i strukturuar në google form për të vlerësuar njohuritë shëndetësore lidhur me vetkujdesin në lidhje me këto sëmundje. Me personat të cilët rezultuan me HTA dhe me nivel të lartë të glicemisë u bënë disa seanca sensibilizimi në lidhje me faktorët të cilët ndikojnë negativisht në shëndetin e tyre. Të gjithë pjesëmarrësit u pajisën me materiale informuese mbi diabetin dhe hipertensionin me fletëpalosje informative.

Rezultate:

Duke analizuar të gjitha të dhënat vumë re që sëmundja e diabetit të sheqerit prek të dy gjinitë pothuajse njësoj me një predominancë të vogël të meshkujve në krahasim me femrat.

Mosha mesatare e pjesëmarrësve në vlera të larta të TA ishte 60 vjec. Nga popullata jonë gjinia femërore përbënte 59%, 51% e përbënin grup mosha 43-62 vjec, 14 % gr.mosha 22-42 vjec. 44% e tyre me arsim të mesëm , 27% me arsim të lartë dhe 29% me arsim tetë vjecar.45% e popullatës e marrë në studim e kishin kaluar kovid 19. 74% e popullatës tonë ishin duhanpirës. 66% e tyre nuk konsumojnë alkool. Në vlerat e matura të glicemisë mbi 200-417mg/dL ishin 8%.

Grafik 1. Paraqitja grafike e përqindjes së popullatës sipas grup-moshave e gjinisë të përfshirë në studim




Mosha mesatare e të gjithë pjesëmarrësve ishte 60 ± 5 vjeç. Nga popullata jonë gjinia femërore përbënte 59%, 51% e përbënin grup mosha 43-62 vjec, 14 % gr.mosha 22-42 vjec.

Grafik 2. Paraqitja grafike e përqindjes së popullatës sipas nivelit arsimor dhe infektimit të popullatës me Covid 19




Përsa i përket statusit 91%ishin të martuar, 44% e tyre me arsim të mesëm , 27% me arsim të lartë dhe 29% me arsim tetë vjecar. 45% e popullatës e marrë në studim e kishin kaluar kovid 19.

Grafik 3. Paraqitja grafike e përqindjes se popullatës lidhur me shpeshësinë e matjes së T.A dhe glicemisë.



E masnin T.A më shumë se 4-6 herë në muaj pothuajse 38% e tyre ndërsa 35% nuk monitorojne asnjëherë. Pothuajse 87% e tyre paraqesin vlera normale të pulsit edhe pse janë identifikuar me HTA në vlera mbi 140-100mmHg 40% e pjesëmarrësve. Matjen e sheqerit në gjak e bënin më shumë se një herë në muaj në masën 42%, 27% e tyre nuk e kishin matur asnjëherë gliceminë në gjak


Grafik 4. Paraqitja grafike e përqindjes së popullatës lidhur me



duhanpirjen dhe alkolin

74% e popullatës tonë ishin duhanpirës, Nga popullta duhanëpirse 41% raporton se pi 3-6 cigare në ditë, 32% 1 paketë në ditë, 25% 10 cigare në ditë, 11% 2 paketa dhe 3% raportojnë se pijnë më shumë. 60% vuanin nga sëmundje kronike. 66% e tyre nuk konsumojnë alkol vetëm 9% e tyre janë përdorues të rregullt të alkolit.

Grafik 5. Paraqitja grafike e përqindjes së popullatës lidhur me BMI dhe vlerat e glicemisë në gjak



Në vlerat e ,matura të glicemisë 59% kishin vlera normale, 33% kishin vlera 120-200 mg/dL dhe mbi 200-417mg/dL ishin 8%. Nga këta 18% paraqitën vlera të rritura të BMI dmth obezë, mbi peshë ishin 27%.

Diskutime:

Mosha mesatare e pacintëve të marrë në studim është 60 ± 5 vjec . Ndërkohë në një studim të zhvilluar ne Zelandë dhe Danimarkë në 174 pacientë mosha mesatare ishte 54.6 vjec. Rezultatet e analizës së karakteristikave socio-demografike tregojnë se femrat janë më të prekura me 69.40% në krahasim me meshkujt 30.60%. Vërehet një shifër e lartë 27.% që tregon për pacientët që nuk e monitorojnë asnjëherë glukozën dhe 35% tensionin arterial apo pulsën. Përsa i përket nivelit të arsimit, u vu re një lidhje sinjifikante për vlera të $p < 0.001$ midis nivelit arsimor dhe njohurive në lidhje me vlerat dhe matjet e herëpashershme të glukozës dhe TA. Një numër i madh individësh me hipertension dhe nivel të lartë të glukozës në gjak, nuk e dinë që vuajnë nga kjo sëmundje. Matjet e presionit arterial dhe sheqerit, rekomandohen në nivel popullatë për të parandaluar zhvillimin e hipertensionit e diabetit, si dhe për të përmirësuar ndërgjegjësimin, trajtimin dhe kontrollin e Hipertensionit dhe glukozës në komunitet. Studimet epidemiologjike kanë treguar se hipertensionit është në përpjesëtim të drejtë me moshën, një gjetje e konfirmuar edhe nga ADHS 2008-09. Për femrat, nivelet e hipertensionit rriten me moshën nga 6 përqind mes femrave në moshën 15-19 vjeç në 40 përqind mes atyre në moshën 45-49 përqind,

ndërkohë që për meshkujt, nivelet katërfishohen nga 11 përqind mes meshkujve në moshën 15-19 vjeç në 45 përqind mes atyre në moshën 45-49 vjeç. Faktorët që lidhen me rritjen e prevalencës së hipertensionit dhe diabetit melitus janë: moshë, gjinia, duhanpirja, alkoli dhe pesha trupore(BMI). Po ashtu, duhet theksuar se jo të gjithë pacientët mund të jenë të familjarizuar me vetëmonitorimin e TA, pulsit, glukozës në gjak, ndaj dhe në këtë rast duhet të bëhet ndërgjegjësim i popullatës si dhe monitorim dhe matje në qendrat shëndetësore. Kjo tregon dhe pse kishim një nr të lartë të pjesëmarrësve që nuk dinin për vlerat normale të këtyre parametrave dhe matjet e pakta që kanë bërë. Impakti i kuptimit drejtë dhe saktë i informacionit të dhënë është i madh kur bëhet fjalë për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme si HTA, DM, pra informacioni duhet të jetë sa më i lexueshëm për të gjitha kategoritë(jo të gjithë mund ti kuptojnë drejt informacionet e dhëna për këto sëmundje)

Konkluzione

- Si përfundim mund të themi që prevalenca e presionit arterial dhe glicemisë ishte më e ulët se sa pritej në Vlorë , në krahasim me studimet e mëparshme që janë bërë në vendin tonë në qytetin e Vlorës, kjo dhe si pasojë e situatës së pandemisë që e bëri popullatën më të ndërgjegjshme për të bërë kontrolle shëndetësore më të shpeshta.
- Preken më tepër meshkujt si për diabetin dhe tensionin e lartë të gjakut , kjo si pasojë e përdorimit të duhanit dhe alkolit.
- U vu re që arsimimi luan rol të rëndësishëm në kujdesin ndaj vetes për të monitoruar parametrat vital dhe për të bërë kontrolle rutinë nëpër qendrat shëndetësore.
- Pesha trupore dhe zakonet e të ushqyerit ishin faktorë kryesorë në shfaqjen e këtyre sëmundjeve duke parë që 18% e tyre ishin obezë.
- Njohuritë nga popullata e marrë në studim si nga pyetëtorët online dhe nga skedat e vlerësimit në terren për njohjen dhe parandalimin e këtyre sëmundjeve, ishin të limituara.

Rekomandime

- Të vlerësohet hipertensioni në praktikën e përditshme, në burra mbi 40 vjec dhe grate mbi 50 vjec ose në postmenopauzë, kur një ose më shumë faktorë rreziku janë të pranishëm si: pirja e duhanit, kequshqyerja ose mbipesha, inaktiviteti fizik, dislipidemitë, hipertensioni ose diabeti melitus, kur ka predispozitë familjare.
- Sensibilizim i popullatës në lidhje me kontrollet e herëpashershme të mbarëvajtjes së shëndetit të tyre.
- Depistimi dhe monitorimi i gjithë individëve që paraqiten në shërbimin parësor duke i orientuar drejt sjelljeve të shëndetshme, eliminimin e faktorëve rrisues dhe ndërgjegjësimi i tyre do të sillte një ulje të konsiderueshme të semundjeve kardiovaskulare.
- Lidhur me edukimin shëndetësor, sugjerojmë që hartohen metodologji të tilla të edukimit, që të jenë të përshtatshme dhe efektive për të gjitha kategoritë e pacientëve.
- Mirëinformimi i popullatës në lidhje me faktorët që mund të ndikojnë në HTA dhe diabet Mellitus, si dhe demonstrimi nëpërmjet posterave

Referencat

1. Yan Zheng^{1,2}, Sylvia H. Ley^{2,4} and Frank B. Hu^{2,3,4}. *Global Aetiology and Epidemiology of Type 2 Diabetes Mellitus and Its Complications*.
2. “Members.” *Idf.org*, 2019, idf.org/our-network/regions-members/europe/members/136-germany.html.
3. “Diabetes Statistics.” *Diabetesresearch.org*, 2017, www.diabetesresearch.org/diabetes-statistics.
4. Ralph A. DeFronzo¹, Ele Ferrannini², Leif Groop³, Robert R. Henry⁴, William H. Herman⁵, Jens Juul Holst⁶, Frank B. Hu⁷, C. Ronald Kahn⁸, Itamar Raz⁹, Gerald I. Shulman¹⁰, Donald C. Simonson¹¹, Marcia A. Testa¹² and Ram Weiss¹³. Type 2 Diabetes Mellitus. Article number: 15019 doi:10.1038/nrdp.2015.19 Published online 23 July 2015.
5. WHO. “Hypertension.” Who.int, World Health Organization: WHO, 16 May 2019, www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/hypertension.
6. Francesca Pistoia¹ • Simona Sacco¹ • Diana Degan¹ • Cindy Tiseo¹ • Raffaele Ornello¹ Antonio Carolei¹. *Hypertension and Stroke: Epidemiological Aspects and Clinical Evaluation*.
7. Martin Rosas-Peralta^a and Gladys Marcela Jimenez-Genchi. *New Challenges for Treatment in Hypertension*. March 16, 2018; accepted November 16, 2018.
8. Massimo Volpe^{1,2} · Giovanna Gallo¹ · Allegra Battistoni¹ · Giuliano Tocci^{1,2}. *Highlights of ESC/ESH 2018 Guidelines on the Management of Hypertension: What Every Doctor Should Know*. Received: 27 October 2018 / Accepted: 23 December 2018.
9. Sarti C, Rastenyte D, Cepaitis Z, Tuomilehto J. International trends in mortality from stroke, 1968 to 1994. *Stroke*. 2000;31:1588–601.
10. Warlow C, Sudlow C, Dennis M, Wardlaw J, Sandercock P. *Stroke*. *Lancet*. 2003;362:1211–24.
11. Marini C, Baldassarre M, Russo T, De Santis F, Sacco S, Ciancarelli I, Carolei A. Burden of first-ever ischemic stroke in the oldest old: evidence from a population-based study. *Neurology*. 2004;62:77–81.
12. James PA, Oparil S, Carter BL, Cushman WC, Dennison-Himmelfarb C, Handler J, Lackland DT, LeFevre ML, MacKenzie TD, Ogedegbe O, Smith SC Jr, Svetkey LP, Taler SJ, Townsend RR, Wright JT Jr, Narva AS, Ortiz E. 2014 evidence-based guideline for the management of high

- blood pressure in adults: report from the panel members appointed to the Eighth Joint National Committee (JNC 8). *JAMA*. 2014;311:507–20.
13. Anand SS, Yusuf S. Stemming the global tsunami of cardiovascular disease. *Lancet*. 2011;377:529–32.
 14. Feigin VL, Lawes CM, Bennett DA, Anderson CS. Stroke epidemiology: a review of population-based studies of incidence, prevalence, and case-fatality in the late 20th century. *Lancet Neurol*. 2003;2:43–53.
 15. Hollander M, Koudstaal PJ, Bots ML, Grobbee DE, Hofman A, Breteler MM. Incidence, risk, and case fatality of first ever stroke in the elderly population. The Rotterdam Study. *J Neurol Neurosurg Psychiatry*. 2003;74:317–21.
 16. Broderick J, Brott T, Kothari R, Miller R, Khoury J, Pancioli A, Gebel J, Mills D, Minneci L, Shukla R. The Greater Cincinnati/ Northern Kentucky Stroke Study: preliminary first-ever and total incidence rates of stroke among blacks. *Stroke*. 1998;29:415–21.
 17. Knight EL, Bohn RL, Wang PS, Glynn RJ, Mogun H, Avorn J. Predictors of uncontrolled hypertension in ambulatory patients. *Hypertension*. 2001;38:809–814
 18. Hicks LS, Fairchild DG, Horng MS, Orav EJ, Bates DW, Ayanian JZ. Determinants of JNC VI guideline adherence, intensity of drug therapy, and blood pressure control by race and ethnicity. *Hypertension*. 2004;44:429–434
 19. McFarlane SI, Jacober SJ, Winer N, et al. Control of cardiovascular risk factors in patients with diabetes and hypertension at urban academic medical centers. *Diabet Care*. 2002;25:718–723.
 20. Tsimihodimos V, Gonzalez-Villalpando C, Meigs JB, Ferrannini E. Hypertension and diabetes mellitus: coprediction and time trajectories. *Hypertension*. 2018;71:422–428

EDUKIMI LIGJOR I PUBLIKUT: ZHVILLIMI I IMPONUAR I DIXHITALIZIMIT TË IAL-VE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (KUADRI LIGJOR DHE KAPACITETET)

Dorian Leka, Ph.D. (cand.)

International University of Struga, d.leka@eust.edu.mk
Nehemiah Gateway University, dorian.leka@ng.university

Abstrakt

Zhvillimi i imponuar i dixhitalizimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë është një temë e gjerë dhe mjaft e komplikuar, edhe pse në trend për shkollat e mendimit bashkëkohor mbi zhvillimin e teknologjive evolutive në profilin e edukimit, biznesit, por jo më pak edhe atë të politikës. Kështu tentohet të fabrikohet një klasë të re lidheshipi dixhital me vokacion drejtimin evolutiv dhe shfrytëzimin e risive teknologjike.

Gjatë këtij studimi do të trajtohen kryesisht të dhëna mbi Institucionet e Arsimit të Lartë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik. Mundësitë këtyre universiteteve për përshtatjen e metodave dhe teknikave të mësimdhënies në kanalet kibernetike; gatishmëria e stafit për lektorim online dhe aftësia për të tejkaluar barrierat e realizimit të orëve laboratorike në kushtet dhe hapërsirat e lejuara nga platformat online, si edhe përkushtimi i studentëve, dëshira apo refuzimi i tyre për të zgjedhur mësimin online ose atë të alternuar, në krahasim me mundësinë për t'u riskuar dhe për t'u kthyer në auditorët e shkollave të tyre.

Studimi së pari interpreton pasojat nga aktet juridike të prodhuara në funksion të menaxhimit të situatës së jashtëzakonshme të pandemisë, marrë në trajtim vetëm nga këndvështrimi i impaktit në arsimin e lartë në Shqipëri dhe të siguruara nga Qendra e Botimeve Zyrtare. Burimet e informacionit janë autentike.

Punimi reflekton gjetjet e drejtpërdrejta nga vetë IAL-të nëpërmjet një pyetësori të zhvilluar online, i cili ju drejtua gjashtëmbëdhjetë universiteteve (publike dhe private), por pjesë e integruar e këtij studimi, është edhe sondazhi i kryer nga organizata aktive në SHC në Republikën e shqipërisë - Qëndresa Qytetare, i cili

trajton një tematikë të përafërt, por nga këndvështrimi i studentëve. Të tjera informacione janë siguruar nga publikimet e universiteteve në rrjetet e tyre sociale zyrtare, publikime të Kuvendit të Shqipërisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Instituti i Statistikave dhe disa analiza nga botime shkencore ndërkombëtare bashkëkohore.

Fjalët kyçe: Institucion i Arsimit të Lartë, Kapacitete infrastrukturore, Staf akademik, Student, Ligje, Urdhra, Dixhitalizim, Mësim online, Evoluim.

1. Adaptimi i ligjeve mbi tranzitin e procesit mësimor për zhvillimin online

Situata me pandeminë aktuale që po përballlet i gjithë globi, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë, nuk mund të përjashtonte edhe Shqipërinë, e cila u gjend tërësisht e papërgatitur për ta përballuar. Këtu, përmendim jo vetëm aspektin financiar, mjekësor dhe administratën publike, por më së shumti profilin arsimor.

According to UNESCO, on 1 April 2020, schools and higher education institutions (HEIs) were closed in 185 countries, affecting 1 542 412 000 learners, which constitute 89.4% of total enrolled learners. At the beginning of May, some countries, experiencing decreasing numbers of cases and deaths, started lifting confinement measures.¹

Të obliguar për të parandaluar shpërndarjen e mëtejshme të COVID-19, edhe Qeveria Shqiptare dhe Komiteti i Përkohshëm “Për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri” propozuan një mori masash restriktive, ndër të cilat renditen edhe ato që u imponuan me aktet konkrete ligjore për mbarëvajtjen e mësimin online dhe institucioneve arsimore.

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të Vendimit të datës 9.3.2020, të Komitetit të Përkohshëm “Për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe të Propozimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nxori Urdhrin Nr. 135, datë 9.3.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19”²

dhe në zbatim të këtij Urdhri u shpreh më pas Ministria e Arsimit, Rinisë dhe

¹ https://www.iau-aiu.net/IMG/pdf/iau_covid19_and_he_survey_report_final_may_2020.pdf, aksesuar së fundmi më 09/11/2020

² <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/09/135/07a95e7a-b538-4420-b888-a392020b116d>, aksesuar së fundmi më 11/11/2020

Sportit nëpërmjet Urdhrit Nr. 91, datë 9.3.2020, “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”³ në vend.

Kështu vijuan 221 akte ligjore⁴

(të përlogaritura deri në datën 15/11/2020) në funksion të masave anti-COVID-19, dhe ndër këto akte, duke përjashtuar sistemin parashkollor,⁵

Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë ka zgjedhur të drejtohet me aktet juridike jo-obligative (kryesisht Udhëzime) në drejtim të institucioneve të arsimit të lartë (publik dhe privat) për të respektuar autonominë e tyre, pa dhënë asnjë Udhëzim plotësues mbi mënyrën, formën apo praktikën e realizimit të mësimin online.

Përgjatë seancës dëgjimore me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, thirrur në datën 19.05.2020, ora 11:00, në Kuvendin e Shqipërisë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ministrja u shpreh “ Mësimi online nuk ndalohet nga ligji i arsimit të lartë, nga rregulloret e ndryshme dhe aktet nënligjore që dalin nga ligji. Pra, që të hiqet ky shqetësim nga diskutimi, mund të them se nuk e kemi të ndaluar të zhvillojmë mësimin online, por nuk është tamam i normuar që t’i orientojë të gjitha universitet ta zhvillojnë në kushte shtëpie në mënyrë të harmonizuar. Unë nuk e di sa është e nevojshme realisht, sepse universitet kanë lirinë që ta organizojnë në mënyrë më të mirë të mundshme këtë gjë. Ndaj, në takimet e rregullta që kemi pasur me rektorët e universiteteve publike, por edhe me rektorët e universiteteve private ne kemi kërkuar që të na sjellin eksperiencat e tyre më të mira dhe, nëse kanë nevojë, të bëjmë një lloj normimi, duke luajtur gjithmonë rolin e koordinatorit me udhëzues, pra jo nëpërmjet urdhrave, rregulloreve apo VKM-ve, sepse nuk na takon neve, por të nxjerrim një udhëzues, nëse ata e shikojnë të nevojshme, për të organizuar punën e tyre nga vjeshta e tutje.”⁶

Natyrisht, tek aktet e mësipërme, për shkakun e lartpërmendur në seancë, nuk gjejmë asnjë rregullim të mundshëm ligjor që lidhet me kompensimet financiare të dëmeve të këtyre institucioneve, mundësi për investim të menjëhershëm në pajisje elektronike, apo qoftë edhe mbulimin financiar të studentëve të pamundur, të cilët nuk kanë mundësi të kenë një pajisje elektronike për mësimin online, apo qoftë edhe përfitimin e internetit në zonën ku banojnë.

³ https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Urdher-Nr.91.dt._09.03.2020.pdf, aksesuar së fundmi më 11/11/2020

⁴ <https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>, aksesuar së fundmi më 12/11/2020

⁵ Në analizë do të trajtohet vetëm menaxhimi i institucioneve të arsimit të lartë, jo ciklet më të ulëta mësimore.

⁶

<https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20200605165639Komisioni%20i%20Medies%2019.05.2020.pdf>, aksesuar së fundmi më 12/11/2020

1.1 Sfidat e përshtatjes së metodave të zgjidhjes

Duke ju referuar deklaratave zyrtare nga MASR, situata paraqitej optimiste, por përtej tyre nuk janë publikuar të dhëna konkrete që dëshmojnë përshtatjen e IAL-ve publike dhe private në vend, duke evidentuar konkretisht cilat janë departamentet, universitetet, zonat dhe studentët që nuk kanë arritur të marrin apo të japin shërbimin arsimor gjatë mësimit online dhe cilat janë mangësitë teknike të tyre.

Në dijeni të kësaj problematike, u prodhuan edhe shkresat dhe aktet e mëpasme ligjore që i krijonin mundësi IAL-ve të rregullojnë procedurat dhe dokumentacionet e nevojshme për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, nëpërmjet shkresës së QShA Nr. 4900 Prot., datë 16.09.2020 “Mbi kërkesat e Institucioneve të Arsimit të Lartë për shtyrjen e periudhës së aplikimeve dhe regjistrimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve dhe për transferimin e studimeve”, për t’i propozuar më pas MASR shtyrje të afateve në kalendarin e miratuar me Urdhër të Përbashkët, të Udhëzimit Nr.15 datë 26.5.2020 “Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10 datë 15.05.2019 Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Duke nxjerrë në vijim Urdhrin Nr. 293, datë 29.09.2020, “Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2020-2021 në Institucionet e Arsimit të Lartë”, të cilat u reflektuan në Urdhrin e Përbashkët Nr. 4, datë 30.09.2020 nga QShA dhe RASH⁷

dhe u miratua dhe shpërnda për zbatim Udhëzuesit për "Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmerren institucionet arsimore".⁸

Pas një situatë kaotike për përshtatjen e parë, studentët u përballën me rikthimin në auditorë gjatë muajit gusht dhe shtator për të marrë leksionet që nuk arritën t’i ndjekin online dhe të mbyllin semestrin e dytë. Ndërkohë, sapo filluan vitin e ri akademik, të rrezikuar, edhe pse Udhëzuesi për masat ndaj Covid-19 i lartpërmendur zbatohet në shumicën e IAL-ve, sërish i pret përshtatja e radhës për të ndjekur mësimin në auditor dhe online, apo si do të zgjedhë të operojë secila prej IAL-ve.

Sa prej studentëve mund ta ndjekin mësimin online? Sa vështirë e ka administrata e MASR dhe ekspertët (kombëtarë e ndërkombëtarë) të Qeverisë Shqiptare për të prodhuar një model të përbashkët për t’u ndjekur nga të gjitha IAL-të: një metodë, një platformë, një standard sistemi lektorimi – kontrolli – vlerësimi, pa çenuar autonominë e tyre, pra, në dakortësim të plotë, në favor të zgjidhjes së problemeve aktuale? Sa universitete zotërojnë mjetet e nevojshme teknike dhe laboratorët e duhur për mbarëvajtjen e leksioneve dhe seminareve, duke përfshirë këtu edhe

⁷ http://qsha.gov.al/infos/matura_2020/urdher_04_qsha_rash.pdf, aksesuar së fundmi më 14/11/2020

⁸ <https://qzb.gov.al/eli/urdher/2020/05/04/289/f2211693-f7ea-445b-99f3-b319cb01d7a2>, aksesuar së fundmi më 14/11/2020

lëndët e profilit praktik apo profesional? Sa profesorë janë trajnuar për lektorim online nëpërmjet platformave opsionale?

2. Gatshmëria dhe kapacitetet e universiteteve

Traditional educational system lacks these advancements and hence we are compelled to use digitalization in our educational system. Online courses, online examinations, digital textbooks, animations, and administrative activities are known and popular ways digitalization in education system. ⁹ Por, ne njihemi gjerësisht me këto instrumenta vetëm pas kohës së shpalljes pandemi të COVID-19.

A ndikoi situata në prioritizimin e investimeve për dixhitalizimin e IAL-ve?

Nëse kalojmë kushtet dhe rrethanat aktuale, do të vijojë të përdoret kjo metodë e alternuar mësimi?

Në funksion të këtij studimi është hartuar një pyetësor online në 8 universitete publike dhe 8 universitete private, duke ju drejtuar stafit akademik dhe personelit administrativ të këtyre IAL-ve, në përpjekje për t'u informuar se cila është gjendja aktuale e universiteteve dhe mundësitë e ofrimit të mësimit online.

Pyetësi është realizuar duke respektuar anonimatën e të anketuarëve dhe synon të nxjerrë në pah kushtet teknike, investimet, infrastrukturën arsimore të përshtatur me mësim online, aftësitë dhe mundësitë e stafit akademik dhe administrativ për dhënien e shërbimeve (arsimore dhe administrative), si edhe në mbyllje – vlerësimin e IAL-ve për situatën që po përjetojnë në kushtet e pandemisë.

2.1 Vlerësimi i Universiteteve

Kampionimi i këtij pyetësi u krye duke siguruar një numër të barabartë përfaqësuesish nga universitete të sektorit publik dhe privat, duke synuar të rezultojë gjithëpërfshirës dhe me një shtrirje profilesh dhe seli të ndryshme në Shqipëri.

⁹ Dr. Satish Marathe, Digitalization in Education Sector, International Journal of Trend in Scientific Research and Development (IJTSRD), ICDEBI- Prabhadevi, Mumbai, Maharashtra, India 2018, pg. 51

A keni program/sistem elektronik për anti-plagjiaturë?

16 responses





Figura 1

Nëse po, cilat tema/punime kalojnë nëpërmjet këtij sistemi kontrollues?

8 responses



Grafiku 1

Nga IAL-të që i janë nënshtruar plotësisht të pyetësorit vetëm 5 prej tyre kanë sistem për identifikimin e plagjiaturave dhe në të kontrollojnë kryesisht temat e master-it shkencore dhe disa prej tyre edhe tezat e nivelit të parë dhe të tretë studimor.

A keni smart-screen në auditorët e leksioneve/seminareve?
16 responses




Figura 2

Nëse po, sa të tillë zotëroni?
8 responses




Figura 3

Sa përdoret/n nga lektorët?
9 responses




Figura 4

Vetëm 6 universitete zotërojnë smart-screen dhe ndër ta, njëri ka 3 smart-screen, ndërsa të tjerët vetëm nga 1. Ndërkohë, 4 e përdorin shpesh, 2 në varësi të lëndëve dhe të tjerët rrallë ose aspak.

A është i pajisur çdo profesor/lektor me pc dhe projektor?

16 responses




Figura 5

Nëse po, sa prej tyre i përdorin për shpjegim gjatë leksioneve/seminareve?

12 responses




Figura 6

Ndërkohë, jo çdo universitet ka në gatishmëri nga një pc/laptop dhe projektor për çdo profesor/lektor, vetëm 8 prej tyre. Ndërsa, për përdorimin e tyre nga ana e profesorëve, 5 universitete kanë staf akademik që i përdorin shpesh dhe 6 universitete disa prej tyre, që i përdorin më rrallë.

A keni një qendër/departament për kërkimin shkencor?

15 responses




Figura 7

Nëse po, sa persona janë të angazhuar?
11 responses



Figura 8

Keni një sallë/zyrë të veçantë për këtë qendër/departament?
15 responses




Figura 9

Nëse po, cilat janë hapësirat, resurset njerëzore dhe mjetet teknike të vendosura në dispozicion?
9 responses



Grafiku 2

Sa botime shkencore të publikuara elektronikisht ka kjo qendër gjatë vitit 2019/2020?
9 responses




Figura 10

A kanë akses të lirë leximi staf akademik, studentët dhe personat e interesuar mbi këto botime?
14 responses



Figura 11

Shumica e IAL-ve kanë departamente/qendra për kërkimin shkencor (12), ndër të cilat 4 nuk kanë asnjë staf të angazhuar; 4 të tjerë kanë 2 persona dhe 2 të tjerë kanë vetëm nga 1 person. Në 8 universitete ka ambiente të veçanta për këtë qendër (godinë ose zyrë), ndërsa në 5 të tjera jo. Kryesisht mbizotëron personeli akademik i angazhuar pranë këtyre qendrave, por kanë përfshirë edhe studentë dhe personel

administrativ. Megjithatë, 6 prej tyre gjatë vitit të kaluar nuk kanë arritur të publikojnë asnjë botim shkencor. Të tjerët nga 1 botim dhe kryeson njëri prej tyre me 15 botime brenda vitit. Vlen të theksohet se në 10 prej këtyre qendrave studentët kanë akses të lirë leximi të botimeve të publikuara.




Figura 12




Figura 13

Edhe pse viti i kaluar ishte një vit akademik i vështirë, sërish 11 prej tyre kanë investuar për t'u rinovuar. Duke evidentuar vetëm njërin që rinovimin e fundit e ka kryer para 5-6 vitesh, të tjerët kanë vijuar me kushte më të mira, mirëmbajtje, deri tek kampus të ri. Por, për investimin e përqëndruar tek baza materiale dhe teknike për dixhitalizimin e shërbimeve akademike dhe administrative kanë investuar vetëm njëri 100%, 3 i kanë dedikuar gjysmën e investimit dhe të tjerët vijojnë me përqindjet 30, 10 ose aspak.

A keni një program/portal komunikimi të brendshëm të universitetit?
16 responses



Figura 14

Keni një program/instrument elektronik apo person të ngarkuar me punë, që kontrollon frekuentimin online?
16 responses




Figura 15

Nëse po, si e vlerësoni frekuentimin online të stafit akademik dhe studentëve?
14 responses




Figura 16

À keni një platformë elektronike për zhvillimin e mësimit online?
16 responses



Figura 17

Nëse po, cila është ajo?
16 responses




Figura 18

Vetëm 14 universitete kanë një sistem/portal elektronik për komunikim të brendshëm dhe 11 prej tyre pohojnë që ka person të ngarkuar me punë për të ndjekur frekuentimin online të stafit dhe studentëve. Në 5 universitete frekuentimi është i lartë, por në 8 prej tyre mesatar dhe tek njëri i ulët.

Nga përdorimi i deritanishëm, si e vlerësoni realizimin e mësimit online?
16 responses




Figura 19

Cilat konsideroni si sfida apo problematika më të madha për mbarëvajtjen e mësimin online?

16 responses



Figura 20

Të gjithë zotërojnë dhe përdorin platformë elektronike të përshtatshme për mësimin online, duke kryesuar aplikacioni Google Classroom, Microsoft Teams dhe Zoom. Por, nga përdorimi i deritanishëm vetëm 4 prej tyre e konsiderojnë shumë të mirë, 6 universitete e cilësojnë të vështirë dhe 5 mesatarisht mirë. Ndërsa, për problematikat më të shpeshta, nga shumica e tyre janë evidentuar vështirësitë teknike dhe realizimi i testeve, për të vijuar me vështirësitë nga përdorimi i lektorëve dhe studentëve, si edhe procesi i vlerësimit. Ndërsa në 4 universitete ka edhe problematika mbi instrumentet/programet e kontrollit, realizimin e leksioneve, seminareve, quizt-eve dhe aktiviteteve.

Si e cilësoni dixhitalizimin e institucionit tuaj arsimor?

16 responses




Figura 21

Nga 16 IAL-të publike dhe private që plotësuan këtë pyetësor, 2 prej tyre e konsiderojnë barrierë, 2 janë në proces përmirësimi, 5 e cilësojnë si sfidant dhe vetëm 7 e konsiderojnë si një hov zhvillimi.

2.2. Vlerësimi i Studentëve

Nëse për IAL-të Pyetësi i mësipërm shteron dilemat mbi kapacitetet teknike dhe parapërgatitjen e tyre mbi tranzitin mësim në auditor – mësim online, duke marrë në konsideratë edhe publikimet mbi gatishmërinë e universiteteve që janë publikuar nga rrjetet sociale të ministrisë dhe vetë universiteteve, nuk mund të themi të njëjtën për këndvështrimin e studentëve. Duket se përshtypjet e studentëve nuk janë analizuar, anketuar, ose të paktën nuk janë bërë publikisht në formë zyrtare. Kjo sepse opinioni i tyre i përgjithshëm për mësimin online është kontradiktor me vendimmarrjen e ministrisë, komitetit të ekspertëve dhe vetë universiteteve.

Këtë pjesë të informacionit janë përpjekur ta vjelin organizma studentorë, portale studentësh dhe portale mediash, të cilat kanë realizuar pyetësorë, anketa dhe intervista masive, duke i publikuar gjetjet e tyre. Ndër ta përmendim Qëndresën Qytetare, Grupimin studentor ABC Tirana Club, Portalin shkollor ALBAS Portalin JOQ Albania etj.

2.2.1. Vlerësimi i procesit mësimor nën ndikimin e pandemisë

Qëndresa Qytetare është një organizatë e themeluar në 15 Nëntor 2016, e cila përbëhet nga një grup profesionistësh të rinj, që besojnë tek pushteti i qytetarit dhe që janë të vendosur për të bërë më të mirën për qytetarët dhe vendin e tyre. Qëndresa e ka nisur punën e saj me arsimin, duke e konsideruar këtë sektor si prioritar për shkak se mund të kthehet njëkohësisht edhe si burim i fenomeneve negative në shoqëri por njëkohësisht edhe si motor i zhvillimit të vendit nëse investohet sic duhet.¹⁰ Gjatë muajve Mars – Prill 2020, Qëndresa Qytetare realizoi një studim mbi Vlerësimin e Situatës së Arsimit të Lartë nën Ndikimin e COVID-19, duke u bazuar në një Pyetësor online, i cili u plotësua nga 720 studentë të 9 universiteteve publike në Shqipëri, sipas kampionimit të vendosur nga organizatorët.

¹⁰ <https://qq.com.al/index.php/rreth-nesh/>, aksesuar së fundmi më 15/11/2020




Figura 24 Përpunimi i të dhënave të Pyetësorit të zhvilluar nga QQ, Tiranë 26/04/2020

Siç mund të shihet qartazi nga të dhënat e reflektuara në fig. 24, 40.9% e studentëve të pyetur nuk kanë pasur akses të vazhdueshëm në internet gjatë periudhës së izolimit, që përbën pothuajse gjysmën e tyre dhe 59.1% kanë patur mundësi të kenë akses në internet. Ndërsa për shkaqet e kësaj problematike, 61% e studentëve që nuk kanë pasur internet pohojnë se arsyet kanë qënë financiare dhe 39% të tjerët shprehen se problemet teknike kanë rrjedhur nga mosmbulimi i zonës me internet. Ndërkohë, për vlerësimin e performancës së universiteteve gjatë izolimit nga pandemia COVID-19, studentët u shprehën se mësimi online filloi 2 dhe 3 javë pas izolimit, pavarësisht Vendimeve të Senateve Akademike dhe Njoftimeve të shpallura nga universitetet. Duke theksuar se edhe Njoftimin për këtë shndërrim nga auditori në klasat dixhitale, e kanë marrë shumica nga media (36.46%), më pas nga universitetet (28.37%) dhe profesorët (24.96) apo shokët/miqtë e tyre (11.21%). Edhe pas ‘normalizimit’ të situatës në kushtet e zhvillimit të mësimin online, sërish vetëm 72.8% e studentëve kanë mundur ta ndjekin mësimin rregullisht, ndërsa 27.2% prej tyre nuk kanë patur mundësi.

3. Përfundime dhe Rekomandime

Vërehet qartazi që IAL-të nuk janë koordinuar dot në kohë dhe nuk kanë marrë udhëzimet e duhura nga MASR për këtë tranzit të paparashikuar të mësimin. Edhe

psë jetojmë në kohën e dixhitalizimit të administratës publike, shëndetësore dhe arsimore, duket që jemi ende larg për ta arritur këtë në nivele të kënaqshme dhe duke u kujdesur që çdo studenti t'i ofrohet shërbimi arsimor adekuat, qoftë ky online.

IAL-të nuk i kanë orientuar investimet e tyre tek infrastruktura e përshtatshme për mësimin online dhe kjo mund të burojë nga shumë arsye të karakterit financiar, caktimi i prioriteteve të tjera, befasia e shfaqjes së pandemisë, vështirësitë e procesit të akreditimit të programeve, mbyllja e degëve nga vendosja e mesatares si kriter skualifikues etj, por natyrisht mund të përmirësohet duke ndërvepruar me Qeverinë për të siguruar mbështetjen e nevojshme.

Megjithëse, shumica universiteteve pohojnë se kanë arritur të përshtaten me mësimin online (informacion i siguruar nga publikimet në rrjetet e tyre sociale) dhe për sa kohë koordinohen me MASR për të respektuar udhëzimet me afate dhe kushte konkrete, duke siguruar mbarëvatjen procedurale për të mos rrezikuar akreditimet, pa shpenzuar (kohë dhe të ardhura) jashtë parashikimit buxhetor mbi efencën masive të shërbimit, duke luhatur në kushte të jashtëzakonshme kualitetin e leksioneve dhe produktivitetin e seminareve; për një institucion që paguan dhe paguhet, qoftë ky arsimor, e rëndësishme është të ketë status aktiv, sepse në të kundërt nuk mund të përsosë veten, as të sigurojë kushtet e përshtatshme për të ndikuar në përsosjen e të tjerëve.

MASR dhe Qeveria duhet të prodhojë akte juridike dhe të ofrojë paketa të specializuara për menaxhimin e kësaj situate, duk përfshirë këtu paketat ndihmëse financiare dhe logjistike (si për IAL-të publike, ashtu edhe për ato private) mbi normalizimin e zhvillimit të mësimin online. Rregullimi dispozitiv i mësimin online dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, për të lejuar universitetet të ofrojnë këtë shërbim që është nevojë e kohës, përtej zgjidhjes së problemeve të shfaqura nga pandemia aktuale, duke i pajisur me Udhëzime konkrete ligjore dhe ndjekjen në kohë reale të zbatimit të tyre.

Duhet evidentuar saktësisht të gjitha universitetet që kanë problematika gjatë kësaj përshtatjeje, si edhe çdo student që nuk mund të marrë shërbimin e duhur arsimor, pa harruar ata të shkencave të aplikuara, që e kanë të pamundur për të zhvilluar praktikat dhe punët në laborator.

Pushtetet lokale, organizatat jofitimprurëse dhe organizmat rinore duhet të bashkëpunojnë më tepër me njëri tjetrin, duke siguruar veprime efikase, si për rrjet informimi në kohë reale, gjetjen e mundësive mbështetëse nga donatorë të huaj, po ashtu edhe për rritjen e ndërgjegjësisimit dhe advokimin e ndikimin në proceset

vendimmarrëse që prekin interesat e tyre.

Kjo është një sfidë e madhe për një vend që të ardhurat për Arsimin i parashikon deri në 3% të PBB¹¹, ndërsa nëse ndahen ndërmjet Arsimit Parauniversitar dhe Arsimit të Mesëm Profesional, Arsimit të Lartë i mbeten jo më shumë se 1% të PBB. Qeveria Shqiptare duhet të parashikojë rritjen e këtij buxheti, si një nga fushat prioritare për zhvillimin e vendit, rritjen e mirëqenies dhe investimin për krijimin e elitës së ardhshme nga radhët e studentëve.

Literatura e shfrytëzuar:

2. Giorgio Marinoni and Hilligje van't Land, The Impact of COVID-19 on Global Higher Education, International Higher Education, The Boston College Center for International Higher Education, Special Issue No. 102 (2020)
3. Dr. Satish Marathe, Digitalization in Education Sector, International Journal of Trend in Scientific Research and Development (IJTSRD), Prabhadevi, Mumbai, Maharashtra, India 2018
4. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Buxheti për Qytetarin, Tiranë 2020
5. Qëndresa Qytetare, Arsimi në Fokus, Studim mbi Vlerësimin e Situatës së Arsimit të Lartë nën Ndikimin e COVID-19, Tiranë 2020

1. Akte Ligjore:

6. Ligji Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
 7. Urdhri Nr. 135, datë 9.3.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19” i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 8. Urdhri Nr. 293, datë 29.09.2020, “Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2020-2021 në Institucionet e Arsimit të Lartë” i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
 9. Urdhri Nr. 91, datë 9.3.2020, “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike” i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

¹¹ <http://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Buxheti-i-Qytetarit-2020.pdf>, aksesuar së fundmi më 15/11/2020

10. Urdhri e Përbashkët Nr. 4, datë 30.09.2020 “Për një ndryshim në Urdhri e Përbashkët Nr.2, datë 02.07.2020 “Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe të Regjistrimit në Programet e Ciklit të Parë të Studimeve, në Programet e Studimeve të Karakterit Profesional, si edhe në Programet e Integruara të Ciklit të Dytë të Studimeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik 2019-2020” nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar
11. Urdhër nr. 289, datë 04. 05. 2020 “Për miratimin e udhëzuesit për "Masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore” i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
12. Udhëzimi Nr.15 datë 26.5.2020 “Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10 datë 15.05.2019 Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

2. Burime elektronike

13. https://www.iau-aiu.net/IMG/pdf/iau_covid19_and_he_survey_report_final_may_2020.pdf
14. <https://www.pwc.co.uk/assets/pdf/the-2018-digital-university-staying-relevant-in-the-digital-age.pdf>
15. <https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>
16. <https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20200605165639Komisioni%20Medies%2019.05.2020.pdf>
17. http://qsha.gov.al/infos/matura_2020/urdher_04_qsha_rash.pdf
18. <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/09/135/07a95e7a-b538-4420-b888-a392020b116d>
19. https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/03/Urdher-Nr.91.dt_.09.03.2020.pdf
20. <https://qq.com.al/index.php/rreth-nesh/>
21. <http://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Buxheti-i-Qytetarit-2020.pdf>



SCfSD '22

www.iust.edu.mk | info@eust.edu.mk | +389 (0)46 786 160
Ezerski Lozja 1, 6330 Struga, R.M.

ISBN 978-608-4573-27-2